

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-32

T 96

# MALET RRINE ZGJUAR...

Nevrus Turhani

814.32  
T96.

NEVRUZ TURHANI

MALET RRINË ZGJUAR .



3222

BOTIM I SHTËFISË QENDRORE TË USHTRISË POFULLLORE

1971

## NË KUDHRËN E REVOLUCIONIT

Ja një ndër të shumtët e armatës së njerëzve tanë, një kuadër i ri në moshë dhe në shërbim. Ecën në rrugën tërë baltë e pellgje uji të fshatit. Atje, rrëzë kodrës, stërviten ushtarë të nënrepartit. Sa mirë është të ndodhesh pranë tyre, t'u qëndrosh në krah, t'i shikosh si stërviten, si derdhin djersë, si i përvetësojnë mësimet, t'i ndihmosh atje ku hasin pengesë, të mësosh nga vullneti, këmbëngulja e tyre, nga shpirti i gjërë i ushtarit, nga thjeshtësia, përzemërsia dhe rreptësia e ushtarit! E pastaj, në krye të orës, gju më gju me ta, t'ia marrësh një kënge, të bësh një shaka, të dëgjosh apo t'u tregosh një ndodhi interesante. Ai është një nga shokët kryesorë të shtabit të nënrepartit, por e di se vendi i tij është atje ku stërvitet dhe kalitet ushtari. Dhe prandaj ecën aq shpejt rrugëve të fshatit. Të arrijë në kohë. Koha do shfrytëzuar me nikoqirllëk. Por ç'janë këto zëra që e bëjnë të kthejë kokën sa djathtas, majtas?

— Si u gdhive, mor bir? — Kjo është një grua e thyer, një kooperativiste, që e njeh mirë atë, që e ka parë sa herë në atë rrugë, arave të kooperativës, nëpër mbledhjet e asamblesë, apo nëpër familjet fshatare. Dhe e thërret: "bir", se ashtu është bërë ai në fshatin ku është vendosur nënrepartit: njeri i afërt, i dashur për të gjithë.

Enver Gaba, në ecje e sipër, u kthen të gjithëve përgjigje. S'ka kohë të qëndrojë sot, e ta tokë me ta. Llogaritë-

sit kanë një mësim të vështirë, e ai e quan detyrë të ndodhet midis tyre, t'i ndihmojë.

Numurorët i gjeti tek topat. Ishte çasti, që sapo u dha komanda: "Për marshim". Qëndroi. Me syrin e një artilleri të stërvitur ndoqi çdo veprim të vartësve. Ata, si të kishin marrë zemër nga ardhja e tij, u treguan më të shpejtë, më të përpiktë.

— Këtë herë më mirë, por ama akoma jemi larg — foli Tahiri.

— Ta përsëritim — propozuan dy ushtarë. — Po në këtë kohë u dëgjua zëri i Kristos. Ai dha komandën për hedhjen e topit për marshim. Kjo bëri që topi i Tahirit t'i ndërpriste veprimet, sepse numurorët, instinktivisht e përqëndruan vëmëndjen tek shokët.

Topi fqinj realizoi normën.

— E patë, sa shpejt vepruan? — foli Tahiri. — E provojmë dhe ne.

— Një minutë, — ishte zëri i eprorit. Ai urdhëroi që numurorët e të dy topave të afroheshin. Pastaj tha:

— A nuk do të ishte më e drejtë që të vepronit në të njëjtën kohë, me të njëjtën komandë? Kështu do të provohej më mirë se cili top përgatitet më shpejt si për marshim, ashtu dhe për luftim. Si thoni?

— Shumë e drejtë!

Dhe kështu, të dy topat u vunë në garë. Pas disa provash, ata që të dy i plotësuan normat me sukses.

Në fund të orës, sapo u dha pushimi dhe Enver Gaba doli nga klasa ku stërviteshin llogaritësit numurorët e futën në mes. Kështu filloi një nga ato bisedat e shkurtëra, por të ngrohta e të përzemërta që ai zhvillon shpesh me ushtarët.

...Disa kohë më parë, me një nga bateritë, zhvillonte një mësim në material artilerie. Për çdo çështje pyeste:

— Më kuptuat?



Dhe pasi nuk merrte asnjë përgjigje, vazhdonte shpjegimin, i bindur se vartësit e kuptonin. Por ja, pas dite, në kohën e lirë, siç ishte duke biseduar me ushtarët, njëri prej tyre e kishte sjellë fjalën tek stërvitja:

— Sikur nuk e përtypëm mirë mësimin në material artilerie.

— Pse?

— Po ja sikur flisni pakë shpejt dhe s'u ndjekim dot...

Me sa kuptoi, ushtari shprehte mendimin e gjithë shoqëve, sepse të gjithë prisnin përgjigjen e tij. "Pse nguruan të ma thoshin këtë gjatë orëve të mësimit? Ç'është kjo ndrojtje. Ku e ka bazën? Mos vallë ka këtu çfaqje të intelektualizmit?" — Kështu mendoi në ato (pak çaste që ushtarët prisnin në heshtje se ç'do të thoshte. Dhe foli:

— Po, në metodën time të mësimit kam mungesa. Ju duhet të më korigjoni, ju duhet të mos kini asnjë ndrojtje.

...Në sistemin e ndriçimit të topave kishte difekte. Për këtë urdhëroi që pajisjet përkatëse të çoheshin në ofiçinë. Veçse, pas ndeshies së voleibollit, kur ushtarët u grumbulluan të diskutonin për repertuarin e grupit amator, në të cilin një rol të rëndësishëm lozte vetë, jo vetëm si konferencier, por edhe autor i disa pjesëve që lidheshin me jetën e nënrepartit, shprehu këtë mendim:

— E meriton të bëjmë edhe diçka për ata që s'kujdesen për sistemin e ndriçimit të topave.

Kjo dha shkak të diskutohej gjatë. E kishte marrë fjalën dhe ushtar Hasani:

— Kemi faj, por jo aq shumë, - kishte thënë.

— Po pse, kujt i takon pjesa tjetër e fajit?

— Unë them se ato s'duheshin çuar në ofiçinë.

— Si, dhe ku t'i rregullonim?

— Këtu, në nënrepart. Ne, ushtarët. Unë, p.sh. jam në

gjendje ta bëj një punë të tillë.

— Pse s'kini thënë më parë?

— E kush na pyeti?...

Disa zëra njëherësh:

— Hasani ka të drejtë. Pse të mos pyetemi për gjithëçka?

Ja një kritikë me vend. Ja dhe një mësim i ri, një mësim i nxjerrë nga të jetuarit, të punuarit bashkë me ushtarët, nga rrahja e mendimeve dhe diskutimi lirisht i problemeve. Qysh prej asaj kohe çdo difekt në sistemin e ndriçimit të topave mënjanohet aty, në nënrepart, brenda një kohe të shkurtër. Gadishmëria nuk çenohet asnjë çast.

... Gjatë bërjes së një ndërtimi, në drejtim të betonimit, avancohej ngadalë. Iu kujtua kritika e ushtarëve: "Pse të mos pyetemi për gjithëçka?" Dhe, megjithëqë kishte nevojë të pushonte, u nis për në objekt. Atje qëndroi disa orë. Në fund, vetë ushtarët, e, në radhë të parë Pajtimi, gjetën rrugë daljen: ata propozuan që puna në betonim të bëhej pa asnjë ndalesë, me ndëresa. Ç'dha kjo? Brenda kohës së caktuar rendimenti u rrit katër herë. Ja ç'bëri mendimi krijues i ushtarit kur ai u nxit dhe u për-krah fuqimisht.

Enver Gaba jeton aty, me vartësit. Atë e tërheq shumë jeta e gjallë në nënrepart, jeta plot dinamizëm dhe e gëzuar. Kjo i përtërin forcat, i rrit optimizmin, e bën të ndjejë lumturi, të ketë një botë të pasur shpirtërore, të krijuar në punë e që i shërben punës. Për të arritur këtu ai nuk e ka patur të lehtë. I është dashur të bëjë luftë me vetveten, luftë ideologjike, të thellojë revolucionin në ndërgjegje.

... Atëhere ishte kursant, bile një ndër më të mirët. Po vinte koha të mbaronte dhe të delte kuadër.

Erdhën provimet dhe në fund emërimet. Në koman-

dën, eprore e njoftuan se do të shkonte në një garnizon larg qytetit, në një fshat. Atje s'kishte as bulevarde e as theatër, as parqe e lulishte. Por atje kishte njerëz, luftëtarë të ndërtimit e të mbrojtjes të socializmit, atje e prinin ushtarët e baterisë, mbi të gjitha, e priste detyra e shtënjtë ku duheshin shkriretë interesat e ngushta personale, në interesat e atdheut, revolucionit; në ndërgjegjën e tij këto interesa duhej të viheshin mbi gjithçka. Dhe u nis sepse e kuptonte ç'ishte detyra, ç'ishin interesat e atdheut. Por thellë në ndërgjegje bëhej luftë. E kjo u pasqyrua që në ditët e para. Ku qyteti me tërë atë gjallëri e aktivitet kulturale, artistik, e ku fshati? Ku vatra e ngrohtë e shtëpisë me gjithë atë përkujdesje, me jetën në bateri? "Jo, jo, duhet të kërkoj të më transferojnë. Pastaj..., po familje, a do të krijoj unë? Pa tjetër. Po këtu në fshat të martohem...". Kjo ishte një luftë e heshtur që e brente në vetvete, një luftë në ndërgjegje, por që s'kishte se si të mos pasqyrohej në veprimtarinë praktike; qëndronte si i mbyllur, jo shumë i afrueshëm me ushtarët, shpesh e më shpesh donte të shkonte në qytet.

Me të bisedoi komisari. "Pa thellëhu, mor djale — kështu nisi t'i flasë ai. — Revolucioni kërkon që nie të japim gjithë forcat, energjitë, zemrën tonë dhe jo atje ku ke ti dëshirë, por ku e kërkojnë interesat e popullit, të atdheut. Më duket se pak studjon, pak thellohesh në mësimet e partisë, të shokut Enver. Pa mësohu t'i bësh pyetje vetes çdo ditë: "ç'studiova sot, ç'mësova dhe ç'kam bërë për të zbatuar në jetë këto mësimet?" Edhe një porosi: afroju më tepër ushtarëve, bisedo me ta, organizo aktivitete bashkë me ta, njihi ata, njihu zemrën. E, sa ke për të mësuar prej tyre! E kam fjalën shkrihu me njerëzit, midis tyre, s'ka rëndësi ku je, duke kryer detyrën së bashku me ta, do të ndjehesh i gëzuar, do të harrosh "ëndërrat", që të rrinë si re, dhe do ta shikosh ashtu siç ësh-

të jetën atje në bateri: jetë luftarake, revolucionare, që do të të rrëmbejë, do të të bëjë për vete. Atëhere do ta kesh më lehtë të zgjedhësh edhe shoqen e jetës, do të krijosh familje, një familje të lumtur, të gëzuar, jetën revolucionare". Në mbrëmje shkoi në shtëpi. Aty e gjeti dhe të jatin.

— Si kalon atje, mor bir? — e pyeti i jati.

— Duhet ta marësh me mend, baba, si në fshat... Jam mërziur që, si të të them...

Por a e kishte njohur ai babanë, ish luftëtarin partizan, komunistin, njeriun që, edhe pse në moshë të thyer, kryente si revolucionar detyrat që i ngarkonte partia sa në një vend në tjetrin, larg familjes, larg rehatisë personale, larg qytetit? Mund të themi se atë mbrëmje e njohu më mirë. Ndër të tjera i jati i tha:

— Ai që është revolucionar, s'nxjerr fjalë të tilla. Nuk psherëtin. Revolucionari do gjoks. Ti, a je në gjëndje t'i vesh gjoksin!..

Kaluan ditë, muaj, kaluan dhe vite. Fjalët e komisarit dhe të të jatis i kujton edhe sot, i kujton sepse me t'u kthyer nga qyteti, lufta në ndërgjegje u ndez më e rreptë, por ato që i bëheshin barikadë, mendimet prapanike, të huaja, nisën t'i humbin pozitën. Mendimi i partisë, ideologjia e saj po i pushtonte zemrën. Aty në nënrepart midis ushtarëve, së bashku me ta, aty midis kooperativistëve e bashkë me ta, ai po e ndjente veten përherë më të fortë, më optimist, më të lumtur. Dhe ai hidhet me vull përpara, i vë gjoksin punës, detyrave. Atë e zgjedhin anëtar të komitetit të rinisë së njësisë, anëtar të plenumit të BRPSH të rrethit.

... Gjatë kohës që ne bisedojmë me të vinë dhe shokë



të tjerë. Përfituam nga ky rast dhe mundëm të mbanim shënim disa nga mendimet e tyre.

“Një ditë - tregon Feriku, kishim marrë detyrën që t’i kalonim topat nëpër një teren të vështirë e t’i vendosnim në pozicionet e reja. Që në çastet e para ndeshëm në vështirësi. Na u duk se detyra s’do të realizohej; topat nuk lëviznin nga vendi. Për këtë gjendje i raportova shokut Gaba. Eprori më dëgjoi me vëmëndje dhe u nisëm sëbashku për tek topat. “Po, tha, me të vërtetë është vështirë: ka baltë, ujë, shiu s’po pushon. Por, si thoni, shokë ushtarë, a mundet që ta lemë detyrën pa kryer?” Pa prituri përgjigje u fut në baltë dhe mbështeti supin tek rrota e topit. “Hajde shokë, të veprojmë njëherësh dhe me një komandë. Më dëgjoni mua...”. Kështu, duke shtyrë vetë dhe njëkohësisht duke komanduar, topi doli nga vendi i vështirë. Kështu u veprua edhe për të dytin, të tretin e me radhë. Detyra u plotësua. Unë, nga ky e sa e sa raste të tjera, mësova shumë, e para së gjithash si ta organizoj punën, si të drejtoj duke dhënë edhe vetë shembullin personal.

Sulejmani, sekretar i organizatës bazë të rinisë, tha: “Duke qënë gjithë kohën pranë nesh, edhe si epror por edhe si shok i afërt, e kemi ndjerë kujdesin dhe ndihmën e tij. Disa herë leximin e shtypit s’e bënim mirë. Kjo i ra në sy dhe për disa ditë ai u muarr vetë me këtë punë. Ne filluam ta lexonim, komentonim dhe të nxirrnim detyra nga shtypi. Ai studion sistematikisht materiale të partisë, veprat e shokut Enver dhe gjen gjithënjë kohë e rast që të na pyesë dhe ne, të na rekomandojë materiale, të na i shpjegojë të na i lidhë ato me jetën dhe detyrat”.

Ata që na folën për të, ishin të shumtë e që të gjithë

çfaqnin mendimin e përbashkët, se ai po kalitet si revolucionar, në kudhrën e revolucionit.

— Po për të krijuar familje — ke menduar e pyesim? Dhe ai tregon gjithçka. Po, aty në fshat, e njohu Valentinën, mësuese e klasës së tretë të shkollës 8-vjeçare, e njohu së afërmi në punë e nëpërmjet punës dhe aty u dashuruan. Por si atij dhe Valentinës iu desh të luftonin, të ngriheshin me guxim ndaj thashethemeve, shpifjeve, ndaj zakoneve prapanike. Dashuria e pastërt, e sinqertë, triumfoi. Ata bënë fejesën. Por ja, diçka e papritur:

Ndodhej me lejë në shtëpi. Aty i vjen lajmi se kërkesa që kishte bërë Valentina për të shkruar vullnetare 1-3 vjet në malësi, si arësimitare, ishte aprovuar. Ai u ndodh midis dy forcave, dy presioneve. Nga njëra anë: "Valentina të shkojë atje, atje është vendi i saj si revolucionare" dhe, nga ana tjetër: "Ti sapo u fejuve, i thuaj të mos shkojë, ç'u kuptua?"

Ato ditë ai sapo ishte pranuar kandidat partie. U mendua thëllë dhe u tha edhe prindërve:

— Si mund ta veçojmë ne lumturinë tonë personale nga ajo e gjithë Shqipërisë? Valentinën e thërret revolucionin dhe ajo duhet t'i përgjigjet me vepra. Pra, si mund t'i dal unë pengesë në vendimin që ka marrë?...

Ai s'mundi ta përcillte. Në atë kohë që ajo ndahej me shoqet e shokët e saj, njeriu më i afërt i zemrës, ai që sapo ishte fejuar, së bashku me ushtarët ngjitnin në një monopat topat. U djersit, gjoksi iu bë tërë baltë, por në kraharor i ndjente fort rrahjet e zemrës: detyra ishte plotësuar. Kur pa orën, ishte vonë. Valentina ishte larg.

Pas disa ditësh mori në dorë letrën e parë. Me këtë letrë në dorë ai shkoi në klasën e tretë të shkollës, atje ku Valentina jepte mësim. Ai atje takoi nxënësit të cilëve

u transmetoi të falat dhe urimet e mësueses së tyre. Njëri nga fëmijët e kishte pyetur:

— A do të shkosh ndonjëherë në fshatin ku është mësuesja jonë?

Ai kishte nguruar t'i përgjigjej.

Pas disa muajsh, kur mbaroi një stërvitje, në të cilën ai ndejti netë të tëra pa gjumë, aty nga mezi i natës bie telefoni. Ishte shefi epror: Ai mori në dorë receptorin. Që nga zëri e njohu.

— Dhe tani të uroj rrugë të mbarë, bëji shumë të fala.

Ai shkoi në Tropojën e largët. Atje e takoi Valentinën dhe mësoi mbi punën që bënte ajo dhe shoqet e saj në malësi, në shërbim të revolucionit.

## MOTIVET

### 1. Panoramë

Masivi malor ngrihet si një kështjellë vigane. Në një nga faqet e tij pemët e vetmuara u ngjajnë kalorësve të përkulur mbi kuaj. Erërat fryjnë me zhurmë. Aty pranë s'ka as qytet, as edhe fshat, por ai vetë është si një qytet. Atij vendi, atij këndi të tokës amtare i japin jetë ushtarët, kuadrot dhe familjet e tyre. Të gjithë sëbashku përbëjnë një familje të madhe, luftarake. Dhe kjo jetë atje rrjedh si një lumë i rëmbyer, plot vrull, siç rrjedh në tërë atdheun, në çdo skaj të tij.

Atje këngën e revolucionit e dëgjon në poligon, netëve me shi kur ushtarët hidhen mbi transhetë e "armikut", në anijet që çajnë dallgët e detit të egërsuar, në vendroje, në klasa, kudo që edukohen e stërviten ushtarët dhe kuadrot. Po aqë madhërisht ajo ndihet në familjet e ushtarakëve, në gratë e fëmijët e tyre që punojnë, mësojnë e stërviten si ata.

### 2. Takimi i parë

Kateri silurues sikur fluturonte. Nga prapa ai linte një si hendek të thellë, por të bardhë. Ai sikur e ndiqte, e ndiqte... Në qiç, mitralieri herë dukej e herë mbulohej nga dallgët, por gjithnjë duart e tij qëndronin të mbërthy-



era pas mitralozit, siç qëndronin duart e komandantit mbi timon, të kryemotoristit në telegraf.

Sytë e komisar Dhiogjenit ndiqnin gjithçka: edhe veprimet e detarëve edhe detin blu që sa vinte bëhej më i egër. Kur kateri binte më ndonjë "grupë" të thellë dhe delte prej saj, ai i kthente sytë nga mitralieri. Kur vështrimet kryqëzoheshin ata sikur diç bisedonin...

Ky ishte takimi i parë me njerëzit e garnizonit me jetën e tyre luftarake, takim në krye të detyrës.

### 3. Jetë me alarme

Edhe ai është detar, koleg dhe shok i atyre që takuam në lundrim. Por e takuam në rrethana të tjera: në shtëpi. Dhe na u duk sikur prekëm me dorë jetën intime të një çifti të ri, botën e pasur shpirtërore të një familje të re të porsakrijuar në atë garnizon. Ata të tregojnë shkurt se si u dashuruan dhe u fejuan, se si u martuan dhe ndalën më tepër në ato aspekte të jetës ku del më në pah karakteri i lartë i njeriut tonë të ri, preokupacioni i tyre për t'i shërbyer më mirë e më shpirt revolucionit.

Asllani na tregoi:

— ... Të më kuptosh, Luiza, atje ndoshta do të të duhet të punosh në ekonominë ndihmëse. Pra, sot mësuese, nesër punëtore në bujqësi. Atje s'ka bulevard, s'ka opera. Atje jeta kërkon guxim, kërkon dhe sakrificë. Shpesh unë s'do të ndodhem edhe në shtëpi. — Ja kështu i thashë një herë kur shkova për ta takuar. Por e dini si m'u përgjegi? "Ke nevojë të më njohësh akoma". Kjo përgjigje më bëri që unë të mos ia zija më në gojë vështirësitë që mund të haste. Me t'u martuar i thashë: "Atje na pret shtëpija, "qyteti i ri, të nisemi".

Në krye të disa ditëve, pasi kishim ardhur në shtëpinë e re më njoftojnë se në nënrepart ishte dhënë alarm. U pregatita menjëherë dhe bëra të dal:

“Do të vonohesh? — më pyeti Luiza. Në vend të përgjigjes ngrita supet dhe sakaq humba në errësirë. U ktheva aty nga mezi i natës. E kuptova se më kishte pritur gjatë, e kuptova nga që mbi tavolinë gjeta mbeturinat e një qiriri që e kishte ndezur sapo ishin fikur dritat. Pranë qiririt të shuar qëndronte Historia e Partisë sonë dhe një fletore me shënime. Pas këtij rasti s’më pyeti më: “a do të vonohesh?”. U mësua me jetën në alarme. Por edhe unë u mësova të mos e gjeja në shtëpi kur kthehesha nga lundrimet, u mësova me ato shënimet e shkurtëra mbi tavolinë: “Jam në shkollë”, ose “kam mbledhje me prindërit” ose “jam në stërvitje” ose “vazhdojmë leximin kolektiv të Historisë së Partisë”... Kështu, pra, në jetën tonë s’ka monotonë e zbrazësirë, por mirëkuptim, bashkëpunim, ka harmoni, mbi bazën për t’i shërbyer në radhë të parë, me tërë forcën, interesave të atdheut, popullit, për të qënë gjithënjë revolucionarë e në ballë të revolucionit. Pra, motivet e larta të revolucionit na bëjnë si mua dhe Luizën, që tani kryen detyrën e drejtoreshës së shkollës 8-vjeçare, ashtu dhe gjithë pjesëtarët e këtij garnizoni, që të gjejmë lumturinë në këtë jetë luftarake, në jetën revolucionare të tërë kolektivit.

#### 4. Si merrte zjarr krenaria

Tek secili, atje gjen diçka të veçantë, diçka të bukur, që të bën të mendohesh.

Para disa vjetësh atje erdhi një vajzë e vogël, fëmijë e një kuadri. Kishte mbaruar vetëm shkollën fillore. Por kaluan muaj e vite dhe vajza rritej, hidhte shtat, rriteshin dhe mendimi, botkuptimi i saj. Ajo iu përvesh punës si punëtore në ekonominë ndihmëse të repartit, u bë si të thuash, bijë e repartit. Dhe ja pse: Kur i ati u largua me detyrë në një repart tjetër, ajo mbeti aty, por

tashmë jo si vajzë e vogël, por e rritur, vajzë, që u martua, lidhi jetën me Qaniun, me një shok që e njohu mirë në punë. Dhe i lindi Diturisë një vajzë po aty, u çaktua dhe kryen detyrën e magazinieres po aty dhe një ditë, po aty, ajo ndjeu gëzimin më të madh në jetë: u pranua kandidate partie.

Atë ditë që në gazetë u botua letra e shokut Enver dërguar shoqes Athina Mile ajo e lexoi dhe e rilexoi atë disa herë. Qaniu, i shoqi, e gjeti tërë gëzim. Ajo e priti me këto fjalë:

— Në këtë letër shkruhet dhe për mua. Po, po, edhe me mua bisedon shoku Enver. Ja, lexo: "... krijo lumturinë për njerëzit dhe atje ku do të derdhësh djersë për lumturinë e përgjithshme, atje do të gjesh edhe ti lumturinë tënde". Fol, Qani, a nuk më takojnë edhe mua këto porosi, të gjithë neve?

— Po, të gjithë neve — iu përgjigj ai duke marrë pjesë në gëzimin e Diturisë, të së shoqes dhe iu kujtuan për një çast fjalët që ajo i kishte thënë dikur: "Edhe këtu, në këtë garnizon do t'i shërbej atdheut. Jeta është kudo ku krijohet, luftohet, ndërtohet dhe mbrohet socializmi". Atë mbrëmje ata sollën në mend shumë kujtime dhe thellë në zemër ndjenin se si merrte zjarr krenaria.

## 5. Ditët pas dasmës

Bëhej dasmë. Por Rrakos, në mbrëmje, dikush i jep në dorë një telegram. Fjalët ishin të pakta, por të qarta, ishte një urdhër i prerë: e kërkonin me urgjencë në repart. Ai kishte tërhequr mënjane Gonin, nusen e re, dhe i kishin treguar telegramin.

— Sot do të nisësh?

— Nesër, pa u hapur mirë dita.

— Mirë, më njofto kur duhet të nisem unë::

Dhe Goni arriti në garnizon pas pak ditësh. Rrakua erdhi shumë vonë në shtëpi. Ai kishte patur një stërvitje të vështirë. Teknika duhej ngjitur në një shpat të pjerët gjithë gurë, duhej ngjitur më shpejt se çdo herë. Për këtë kishte mbledhur efektivin. Por prova e parë s'doli me sukses. Norma jo vetëm nuk u thye, por as nuk u realizua. Kjo e kishte bërë të mendohej, të gjente rrugët e mundëshme për t'i dalë në krye detyrës.

— Kush del vullnetar, shokë. Ta përsëritim edhe një herë? — u ishte drejtuar ushtarëve. Dolën të gjithë. “Kjo është gjë shumë e mirë” — kishte thënë me vete dhe caktoi disa vetë. Ai i vuri gjoksin teknikës dhe komandoi për të filluar lëvizjen. U djersit, rrëshqiti, u bë me baltë, po kur doli në vendin e duhur dhe shikoi orën, buzëqeshi: “Para kohës” — u tha ushtarëve. Ata shpërthyen në “urra” të fuqishme. Kështu vazhdoi deri vonë, deri sa 40 përqind e nënrepartit e theu normën.

— Të tjerët të pregatiten për nesër — u kishte thënë dhe vetëm atëhere iu kujtua se e prisnin në shtëpi. Goni nuk ishte habitur kur e kishte parë ashtu të lagur, vende vende edhe me baltë, përkundrazi i kishte thënë:

— Ke punuar edhe vetë, ë?...

Të nesërmen, ajo, ish llogaritarja e kooperativës iu përvesh punës në ekonominë ndihmëse të repartit, më pas u rreshtua edhe përkrah shoqeve dhe shkoi në poligon. Kështu e filloi jetën Goni në garnizonin e largët, jetë që ajo e ndjen, e prek dhe merr pjesë në të sëbashku me Rrakon, të shoqin, sëbashku me tërë atë kolektiv luftarak.

## 6. Ato i gjen në çdo front

Do t'u kishim dhënë fund këtyre shënimeve. Por ja, Koçua na ka zënë “pritë”.



— Shtoni edhe diçka, thotë ai, diçka më përgjithësuere. Në garnizonin tonë...

Po! Atje zhvillohet punë e gjithanëshme ideopolitike, ushtarake, shoqërore me ushtarakët dhe familjet e tyre. Vetëm për gratë janë ngritur tre grupe të përgatitjes politike dhe me to zhvillohen rregullisht tema, biseda informacione. Por më kryesorja është se atje janë marrë masa të gjithanëshme për t'u krijuar mundësi grave që të punojnë, që ato në punë e nëpërmjet saj të rritin personalitetin, të edukohen, të bëhen të afta e të dobishme për shoqërinë. Gratë atje i gjen në shumë sektorë pune: 60 përqind e tyre janë në ekonominë ndihmëse, disa në çerdhe, në kopësht, në tregëti, në administratë, dhe kudo dallohen si punëtoze të mira.

Por jo vetëm kaq. Gratë e këtij garnizoni janë edhe ushtarë të mira, të përgatitura, ato mbushin radhët e çetës vullnetare. Në qitjet që kanë zhvilluar si me pushkë, mitralozë, granatë, rezultatet kanë qënë të tilla që flasin për gadishmërinë dhe shpirtin luftarak të tyre.

Këto e sa e sa aspekte të tjera nga jeta e këtij garnizoni hedhin dritë mbi atë të vërtetë të madhe se kudo tek ne punohet, jetohet e mësohet në mënyrë revolucionare, se janë motivet e revolucionit, idetë e partisë e të shokut Enver ato që frymëzojnë dhe ushqejnë mendjet dhe zemrat e njerëzve tanë, armatën e madhe të ndërtuesve dhe mbrojtësve të socializmit.



---

## NJË NGA KRAHËT E ÇELIKTA TË PARTISË

Ata janë krahët e hekurt të partisë, janë bijt e saj, që marrin zjarr nga zjarri i saj, gjak, nga gjaku i saj. Ata u ngjajnë shqiponjave që fluturojnë lart, shpejt, që çajnë qiejt me sytë në shënjestër, me mendje e zemër tek At-dheu. Ai i ka caktuar të bëjnë roje, të ruajnë qiellin e kaltër, që gjokset e njerëzve të thithin gjithnjë ajër të pastërt, plot jetë. Ata janë roje të jetës, të revolucionit.

Dhe ja ku janë ata, pilotët: pranë aeroplanëve, gati për t'u nisur, gati të sulmojnë lartësitë. Aty ndodhet edhe ai, djaloshi nga Korça, Rolandi, ish mekaniku i SMT-së, biri i një punëtori, një ndër pilotët e parë të shkollës sonë të aviacionit. Qëndron aty dhe pret radhën të ngrihet, të shkaputet nga toka nënë, me maqinën luftarake, që ia ka dhënë populli, revolucionit, për t'i shërbyer atij me tërë forcën e zemrës. Sot ai do të kryejë në çift një ushtrim të vështirë: "sulme tipike" mbi kundërshtarin. Sot ai, ashtu si gjithë shokët, merr pjesë në betejë. Ata gjithnjë janë në luftë për zbatimin e detyrave, gjithnjë në roje. Dhe kjo i ka çelikosur, kjo i ka bërë të fortë, si vetë At-dheun, Shqipërinë që punon, ndërton dhe mbron revolucionin, marshimin ngadhënjimtar.

... Në krah ka Bardhylin, udhëheqësin e çiftit.

— 540-ta gati! — Ja, këto dy fjalë shqiptoi Rolandi. Ndërsa udhëheqësi i çiftit raporton:

— 539-ta, lëshim në çift!

— Ju lejoj lëshimin...

Të prerë, të qartë, dëgjojnë ata zërin e udhëheqësit të fluturimit. Të dy aeroplanët dalin në brezin e ngritjes. Përsëri raportime, përsëri po ai i zë i prerë:

— 539-ta, ju lejoj ngritjen. Pika juaj...

Maqinat luftarake uturijnë. Toka sikur dridhet. Aeroplanët lëvizin me shpejtësi, përpara, i lëvizin Rolandi me Bardhylin, duart e tyre, zemrat e tyre, mëndjet e tyre.

Shokët, që e kanë mbaruar stërvitjen, ndjekin me sy lëvizjen e çiftit të fundit që rëshqet me vertikal mbi pistën prej betoni. Dhe ashtu, në heshtje, u urojmë atyre që janë në kabinë, rrugë të mbarë, sukses në kryerjen e detyrës, u urojmë që "sulmet tipike" t'i realizojnë si të jenë në kushte të vërteta lufte, për ta asgjësuar, për ta bërë copë e çikë armikun që do të guxonte të prekte hapësirën tonë, frymëmarjen tonë... Por ja, dikujt, për një çast, sikur i ngriu fjala në buzë, dikujt iu shua buzëqeshja, një tjetrit, dora që përshëndeste i mbeti si e ngritur, një të katërti i ragëtiu zemra më fort se çdo herë. Që larg u dëgjua një krismë e fortë, më e fortë se zhurma e turbinave. Jehona e saj u ndie në tërë aerodromin. Të gjithë kthyen sytë nga dy aeroplanët që "vraponin" nëpër pistë, pranë e pranë, të gjithëve u shkoi mendja tek Rolandi, tek ai djaloshi i hequr në fytyrë e trup mesatar, tek sytë e tij të gjallë e të mprehtë. Po, krismën e shkaktoi rrota e djathtë e aeroplanit të tij. Ajo ishte çarë, asaj i kishte mbetur vetëm disku. "Ç'po bën ai në këto çaste? Si do ta përballojë këtë situatë? Si do të veprojë? A do të ruajë gjakftohtësinë?" Sa e sa pyetje të tilla u lindën njerëzve në këto çaste, pyetje që kërkonin përgjigje. Dhe këtë do t'ua jepte ai, Rolandi. Do t'ua jepte me veprimet e tij, me gjakftohtësinë, guximin, vendosmërinë, besimin e tij, me këto veti aq të domosdoshme për pilotin, veti që kultivohen nga partia nëpërmjet një pune

të vazhdueshme edukative, stërvitjes intensive, nëpërmjet kalitjes së pandërprerë të vullnetit, të karakterit dhe aftësisë për t'i bërë ballë çdo vështirësie, çdo rreziku, për të fituar mbi to. Dhe të gjithë e dinin se Rolandi ishte i pajisur me këto; por prisnin që ai t'i demonstronte, t'i çfaqet me tërë shkëlqimin e tyre, sepse asnjëri, përveç atij, nuk i kishte ndodhur një e papritur e tillë. Edhe në literaturë për raste të tilla flitet pak. Gjithçka i mbetej pilotit ta bënte.

Dhe piloti bëri gjithçka, mbi të gjitha ruajti gjakftohësinë, mëndjen e kthjellët. Ai, duke qënë në kabinë, duke mbajtur distancën dhe intervalin nga shoku dhe drejtimin, nuk e ndjeu krismën që bëri rrota, por diçka tjetër: shmangien e aeroplanit nga e djathta. "Çdo të jetë kjo?" — pyeti veten. Dhe po aq shpejt u përgjigj: "Me siguri do të jetë çarë rrota e djathtë". Një e papritur që i ndodhi në brezin e dytë të ngritjes, me plot rreziqe. Por ai e ruajti gjaktohtësinë, nuk iu përpëliten sytë, nuk iu drodh dora mbi levë, por e tërhoqi atë nga vetja dhe e detyroi maqinën luftarake t'i bindet vullnetit të tij, vullnetit të pilotit tonë. Aeroplani u shkëput nga toka dhe u lëshua si shigjetë drejt horizontit, përkrah udhëheqësit të çiftit, përkrah shokut. Tani mund të raportonte:

— 540-ta! Mu çar rrota e djathtë.

Në këtë raportim, udhëheqësi i fluturimit, të gjithë ata që ishin në aerodrom, ndjenin diçka madhështore, solemne: forcën e pilotit tonë, besimin e tij në vetvete për të përballuar vështirësitë, për të plotësuar detyrën.

... Të dy aeroplanët arritën në zonën e caktuar në lartësinë e dhënë. Aty do të zhvilloheshin "sulmet tipike", aty do të manifestoheshin guximi, mprehtësia, zotësia, shkathtësia, vendosmëria e pilotit, aty do të delnin mbi të gjitha qartësia dhe pjekuria ideologjike dhe politike,



do të delnin më në pah aftësitë profesionale, aty edhe do të rriteshin më tej ato, aty Rolandi dhe shoku i tij do të derdhnin gjithë urrejtjen ndaj armiqve.

— 540-ta, zini vend për sulm!

Rolandi merr distancën e nevojshme, pregatitet të sulmojë, sulmon nga e djathta, sulmon me guxim, me vendosmëri. Në qendër të rrethit është aeroplani “armik”. Ai duhet asgjësuar, mbi të duhet derdhur gjithë urrejtja. Dhe “zjarri” që hap piloti është vdekjeprurës. Pastaj, duke mos u vetëkënaqur raporton:

— 540-ta, dal nga sulmi..

Por përsëri kundërshtari vihet në shënjestrën e tij, përsëri në qendër të rrethit, e përsëri, herë nga e majta, nga lart, nga poshtë, ai e sulmon dhe fiton.

Pas pak zë vendin e udhëheqësit të çiftit. Në “sulmet tipike” stërvitet tani 539-ta, Bardhyli. Rolandi tashmë fluturon horizontalisht, ai mund edhe të mendojë, mund edhe të hedhë shikimin poshtë, fushave që jeshilojnë, qyteteve nga ngrihen si kundërajrorë oxhaqet e fabrikave, uzinave, mund edhe të kujtojë diçka, sepse aty, në kabinën e tij ai s'është vetëm, aty ai ndjen, jeton me Atdheun, me pulsin e tij, merr frymë bashkë me të... Por detyrë akoma s'ka mbëruar, ai është i dhënë i tëri pas saj, ai pret shokun t'i dalë në krah.

Kur erdhi ky çast ndjen në kufje zërin e qetë, të ngroh të të Bardhyllit:

— Si je, 540-ta?

— Në rregull...

Po, tani mund të mendonte për uljen, sepse ishin larguar nga zona dhe shkonin drejt aerodromit. Diku edhe u shpërndanë, për të vepruar të pavarur. Në kabinën e vogël të Rolandit nisi lufta e ndjenjave, lufta me ndërjegjen, nisi ajo atje, thellë në gjoksin e djaloshit. Tani fillonte prova tjetër, më e vështirë, më e rrezikshme që kër-

konte përsëri gjakftohtësi, përsëri guxim, trimëri, vendosmëri e besim në vetvete, aftësi të mëdha profesionale.

Ndoshta për një çast, por atij, aty në kabinë, i kaluan parasysh heronjtë e djeshëm e të sotëm, veprat e tyre, gjaku e djersa e tyre, i kaloi Bilali, kolegu, shoku, vëllai i tij që e uli aeroplanin me motor të shuar nga gjithë ajo lartësi. E sikur ndjeu zërin e tyre: "Vështirë, por a ka për ne, bijtë e shqipës, bijtë e partisë, vështirësi që të mos i përballojmë? Vepro me guxim..."

Tashmë është vetëm 100 metra lart nga toka. Në zërin e udhëheqësit të fluturimit, të komandantit, ndjen zërin e shokëve, zërin e dashur të Atdheut, ndjen frymëmarrjen e tij.

Ka menduar ai si do ta ulë aeroplanin, por pret se ç'do t'i thotë udhëheqësi i fluturimit. Dhe ja, pasi ka bërë dhe dy rrotullime që të harxhohet një pjesë e karburantit e të pakësohet pesha e aeroplanit, dëgjo:

— 540-ta. Kujdes, bëni ulje nga e majta, shpejtësi sa më të vogël, pëshën më të madhe ia lini rrotës së majtë...

— Kuptoval! — Sa qartë tingëlloi kjo fjalë, ç'optimizëm e vendosmëri përmbante ajo, ç'forcë fshihej pas saj. Mendimet e tij puqeshin me urdhërin e udhëheqësit të fluturimit, edhe ai ashtu kishte vendosur ta ulte aeroplanin.

Dhe ja, takimi i parë me tokën. Tufa të tëra shkëndijash u përhapën, ato sikur mbinin nga toka, ato sikur donin t'i jepnin zjarr maqinës luftarake. Por atë e drejtonin duar të sigurta, të shkathta, të stërvitura. Ai, piloti guximtar, nuk e humbi toruan edhe pse aeroplani u shmang nga e djathta, edhe pse nga çasti në çast mund të rrezikonte veten. Jo, ai e kishte marë vendimin me kohë: "Aeroplanin ta ul pa e dëmtuar, ai është pronë e popullit, i shërben popullit".

...Ai doli nga kabina dhe fytyrën ia rrahu ajri i ftohtë

i dimrit. Zbriti dhe, puna e parë që bëri, filloi të kontrollonte aeroplanin. Por s'pati kohë të shkonte deri tek rrota që i kishte mbetur vetëm disku. U përfshi në krahët e shokëve, në përqafimet, në gëzimin e tyre.

Të tillë janë njerëzit tanë, pilotët tanë: trima e të thjeshtë, heronj të heshtur të epokës së madhe revolucionare socialiste.

---

## PROVË KALITJEJE

Komisarit i thanë se ushtar Pirua ishte i shqetësuar. Kjo dukej në qëndrimin e sjelljet e tij: fliste rrallë e rrinte i menduar. Komisarari vuri buzën në gaz dhe pastaj foli:

— Kjo është një shenjë e mirë. Do të thotë se tek Pirua diçka ka filluar të lëvizë në ndërgjegje, se forca e kolektivit, po e vë në pozita më luftarake... Mos harroni, është i shqetësuar ai që në shumë raste, kritikant "këtej i hynin e këtej i dilnin", që s'para i bëhej vonë, ai për të cilin ne thoshim: "Nuk s'kuqet Pirua". Kurse sot...

Kjo bisedë zhvillohej një ditë më parë se kolektivi të zhvillonte provën përfundimtare në krosin disa kilometra. Nënreparti ishte rreshtuar. Deda, pasi kontrolloi një për një vartësit, paimet e tyre, kërkoi lejë dhe krosi filloi. Ishin disa kilometra rrugë që duheshin përshkuar me vrap, duke patur mbi shpinë një ngarkesë të madhe. Pra, duhej energji, rezistencë, këmbë e shpatulla të forta. Deri në një farë vendi nënreparti eci kompakt. Në krye qëndronte vetë Deda. Kthente kokën pas dhe kënaqej kur shikonte vartësit që nuk i ndaheshin asnjë hap. Por ja, kompaktësia u prish. Pirua e ngadalësoi vrapin, pastaj kaloi në ecjen me hap e më në fund, qëndroi. Doli nga rreshti dhe foli:

"S'mundem. Mu zu fryma..." Shokët i folën, dikush i futi dhe krahun për ta marrë me vete, një tjetër i propo-

zoi t'i mbante çantën e shpinës, por ai qëndroi në të tijën: "S'mundem..."

Komandanti e kuptoi se diçka po ndodhte nga fundi. Pa e ngadalësuar ritmin e vrapimit ktheu kokën pas. E pa Piron që kishte dalë nga rreshti e po hiqte çantën e shpinës. Por nuk u kthye ta pyeste ç'kishte e pse u nda nga shokët.

Në kilometrin e caktuar u bë kthesa. Nënreparti vazhdoi të ecte si një bllok i vetëm, me ritëm të shpejtë.

— Jepni djema! Kemi edhe gjysmën e rrugës — u dha zemër komandanti.

Piron e arritën tek po kthehej në nënrepart fill i vetëm, me çantën e shpinës në dorë. Komandanti dhe shokët i kaluan fare pranë. Asnjë nuk i foli, asnjë nuk ia hodhi sytë. Ai përsëri mbeti vetëm, më prapa, me mendimet e tij.

... Komisar Fejzua futi në xhep kronometrin dhe u drejtua për nga fjetorja. Ushtarët, me në krye Dëdën, ishin rreshtuar. Të gjithëve u gufonte gjoksi. Xhaketat u ishin bërë për t'u shtrydhur. Komandanti dha komandën dhe u bë gati të raportonte. Por komisari e ndërpreu.

— Ç'tu them — nisi të fliste ai, shikoni se ku kanë mbetur akrepat e orës. Ky është një rezultat i shkëlqyer, u lumtë!

Në fytyrat e ushtarëve, pas këtyre fjalëve, ai dëshironte të shihte se si do të ndizej gëzimi, krenaria. Por jo. Ato ishin fytyra tërë djersë e pluhur, të rrepta, serioze. Në to vështirë të shquaje atë gëzim që lind pas një suksesi.

... Pirua priste që komandanti t'i bërtiste, por edhe kjo nuk ndodhi. Dy ditë më parë, po në atë vend, komandanti e kishte nxjerrë para shokëve, i kishte thënë: "Nga shëndeti je ndoshta më mirë se disa të tjerë, fuqija s'të mungon. Atëhere pse ndahesh nga shokët, nga kolektivi? A e kupton se kroshi është detyrë luftarake?" Dhe

priste përsëri që nënreparti t'i dëgjonte prapë këto fjalë, të ndodhej rishtaz nën shikimet e rrepta të shokëve.. Dhe u pregatit të përgjigjej, si gjithmonë: "Kaq mundem!" Por ja, asnjëra nga këto nuk ndodhi. Atij i mbetën sytë të ngulura mbi shpinat e shokëve deri sa ata muarën kthesën, deri sa ata sikur u fshehën pas kodrës së zhveshur. Kjo i pikoi në zemër. Për herë të parë ndjeu sikur po i digjeshin faqet, për herë të parë pyeti dhe iu përgjigj vetes: "Si kështu? Mos vallë s'më futin fare në defter?" I dolën përpara sysh fytyrat e Përparimit e Sinanit, të Dedës dhe të komisarit, të të gjithë shokëve, të të gjithë kolektivit. Të gjithë sikur shprehnin një mendim të vetëm: "Piros i mungon vullneti, Piros i pëlqen të mos e lodhë veten, i pëlqen rehatia". Nisi të shpejtonte hapat.

... Atë mbrëmje nuk u bë mbledhja e kolektivit. Ishte marrë një aksion për të mbartur dru për djegien e furrës së gëlqeres dhe të gjithë ishin të preokupuar. Kjo punë vazhdoi deri në orët e vona të mbrëmjes. Si gjithnjë, edhe në këtë aksion kuadrot qëndronin në krye udhëhiqnin me shembullin personal, mbanin dru njësoj si ushtarët. Herë të tjera kjo s'i kishte bërë ndonjë përshtypje të madhe Piros. Për çudi, atë ditë, kur kujtoi se si Deda qëndroi në krye prej fillimit deri në fund të krosit, dhe përsëri, si ai, ashtu edhe komisarit e kuadrot e tjera së bashku me ushtarët transportonin dru, kjo jo vetëm i bëri përshtypje të thellë, por e vuri dhe në mendime.

Ndërsa i ngjitej të përpjetës, dëgjoj që dikush i thirri. Ishte një nga shokët, Përparimi.

— A u lodhe Piro?

— Më lërë në hallin tim. Nëse lodhem ose jo, s'ka ç'të duhet ty!

— Ja që s'mund të të lëmë rehat.



Por, si ta kishin bërë me fjalë, pas Përparimit, vinte Kozmai. Edhe ai i tha të njëjtat fjalë.

— I dëgjove fjalët që i thashë Përparimit?

— Po!

— Më lerë, atëhere...

Por shokët s'kishin si ta linin Piron të bluante me vetë. Ata e kuptonin se tek ai diç po ndodhte dhe donin që lufta që ai zhvillonte me veten, të vazhdonte, të nxitej edhe nga kolektivi. Ai do ta mësonte, do ta orientonte, do t'i tregonte se ç'qëndrim të mbante ndaj detyrës, ndaj vetes, eprorëve e shokëve.

Dhe të parët që e muarën fjalën në mbledhjen e kolektivit ishin Përparimi, Kozmai, Sinani, Vangjeli. Kritikuan atë, kritikuan dhe veten që s'kishin treguar sa duhej këmbëngulje e takt në punën individuale që kishin bërë me Piron, që s'ishin treguar aq të durueshëm me të, për ta bindur se detyra ushtarake do stërvitje të vazhdueshme, do kalitje fizike, do vullnet. Pirua i dëgjonte, por jo si herët e tjera që i ndërpriste shokët kur e kritikonin, por me vëmëndje, kokëulur. I thanë të merrte fjalën.

— Këtë herë s'mund të them asgjë... Gjithnjë kam folur, kam premtuar por... Jo, këtë herë s'mund t'u them asnjë fjalë. Më lini t'i shoshit edhe një herë porositë që më dhatë, të thellohem në materialet që më rekomanduat për të studiuar.

Shokët e kuptuan Piron dhe nuk kërkuan që të bënte autokritikë. Ato pak fjalë që tha ishin më shumë se një autokritikë dhe premtim.

... Mbetej dhe një ditë nga prova përfundimtare. Të gjithë shprehnin besim të patundur, optimizëm për fitore, të gjithë kishin në gojë vetëm krosin dhe secili thoshte se stërvitjet që kishin bërë i kishin kalitur mirë. Vetëm Pirua qëndronte si i ftohtë, s'para përzejehj në bisedat e shokëve. Edhe kur komandanti i pyeti në mbrëmje var-

tësit se si do të delnin, Pirua ishte i vetmi që nuk çfaqti asnjë mendim. Deda desh të bisedonte veçmas me të, por hoqi dorë. Që nga mbledhja, Pirua kishte hyrë në rrugën e kolektivit. Në provat që ishin bërë në kros, jo vetëm s'ishte shmangur, por kishte treguar qëndresë. Jo vetëm kaq. Në një marshim të gjatë nëpër një teren tepër malor, ai ishte treguar i guximshëm gjatë ngjites në shkëmb. Komandanti dhe ushtarët i kishin folur me simpati komisarit për këtë qëndrim të Pirosh. Dhe komisar i kishte thënë: "Pirua do të ecë në një hap me kolektivin, të jini të bindur, unë kam biseduar me të". Kur u nda nga ushtarët foli me vete: "Ai s'ka për të na turpëruar!" Këtë bindje ia forcoi edhe biseda me komisarin. Dhe ashtu ndodhi. Nga krosi disa kilometrash, i gjithë kolektivi u kthye si një bllok i vetëm dhe meritoi notën shkëlqyeshëm. Veçanërisht për Piron, ai qe një provë e vështirë, provë kalitjeje e ndërjegjjes revolucionare.

## NGA PORTRETI I NJË KOLEKTIVI

Ata janë pjesëtarë të një kolektivi luftarak dhe secili e kupton, e ndjen, se në kudhrën e tij është kalitur, është bërë më burrëror, ka fituar cilësitë e ushtarit revolucionar. Për këtë, çdo njëri është gati të tregojë shembëlla e fakte nga jeta në repart dhe të provojë se tani asnjeri prej tyre, s'është ai që ka qënë këtu e disa muaj, ose një vit më parë.

— Nuk e kemi njohur njeri tjetrin. Në ushtri u njohëm, u afruam, lidhëm miqësi, farkëtuam atë që quhet shoqëri ushtarake. Këtu, më mirë se kudo, kuptuam se çdo të thotë parulla revolucionare: “Një për të gjithë, të gjithë për një”. Do t’u tregoj një rast:

Ishin ditët e para. Diamanti, një ditë kur binte shi e topat duheshin, ngjitur në kodër, ju shmang detyrës. Të nesërmen atë e urdhëroi komandanti i skuadrës për të kryer një detyrë: “Pse, unë?...” — filloi ai të diskutonte. Të gjitha këto veprime unë dhe shokët e tjerë i shikonim, i kuptonim se nuk ishin të drejta, por mbanim qëndrim indiferent: “Ç’na duhet ne? — thoshim — atë s’e njohim!” Por ditët kalonin dhe ishte e pamundur që ky qëndrim i shokut të mos na shqetësonte. Puna ishte se ai, më veprimet e tij, në radhë të parë, cënonte interesin e përgjithshëm; dëmtonte kolektivin, pastaj veten. Pra a mund të heshtnim? Jo. U ngrita dhe e kritikova në një mbledhje. Ai u habit. “Po ti, Seit, ç’ke me mua?...” Pas-

taj u ngritën dhe të tjerë. Diamanti nuk e priste këtë. Ish-te hera e parë që ai po e ndjente forcën e kolektivit, të atij kolektivi që e kritikonte sepse e donte. Shokët më ngarkuan të punoja individualisht me të. Kjo ishte detyra e parë që më ngarkonte kolektivi. Dhe fillova të studjona sëbashku me Diamantin materiale të partisë dhe veprat e shokut Enver, të diskutonja, të shkëmbenja mendime me të, ta ndihmonja për të kapërxyer vështirësitë. Kështu ai filloi të më kuptojë mua dhe tërë kolektivin, filloi të ecë në një hap me të, të edukohet e të kalitet në kudhrën e shoqërisë ushtarake. Sot Diamanti është një ndër shënjesit më të mirë, mbi të gjitha, një pjestar i denjë i kolektivit.

Nëpër këtë rrugë, nën këtë kudhër, nëpërmjet kritikës e autokritikës, kontrollit e vetkontrollit, ka kaluar secili nga ne, dhe çdo njeri e kupton sa shumë kanë bërë shokët për të, sa mendime e koncepte të gabuara ka flakur, sa mendime e koncepte të reja ka përvetësuar.

Mësimet e Partisë e të shokut Enver kanë depërtuar thellë e më thellë në ndërgjegjen tonë. Ja burimi i rritjes sonë. Ushtria është shkollë, vendi ku kaliten vetitë e burrërisë...

Ne ishim ulur në një kënd të fushës dhe fjalët plot frymëzim të Seitit të dukej sikur delnin edhe nga zemrat e të tjerëve. Ata dëgjonin dhe aprovonin ato që thoshte shoku i tyre, ata përsëritnin: "Po, ushtria është shkollë, vendi ku kaliten vetitë e burrërisë".

Këto fjalë duallën edhe nga goja e komandantit të topit, Pashkos. Dhe diç desh të tregonte. Por nuk foli. Lëvizi kokën dhe pastaj... e treti vështrimin diku larg. Shokët e kuptuan se ç'donte të thoshte me këtë. Dhe stallën në mënd atë pasdite, kur jehoi i fuqishëm zëri i komandantit.

— Ndal! "Tanket e armikut"...

Ushtarët zbritën me shpejtësi nga maqinat, stakuan topat dhe filluan përgatitjet për të pritur "armikun" me zjarr. Por një urdhër i ri, bëri të ndërpriteshin veprimet. Topi që komandonte Pashku duhej të vendosej në një pozicion të ri, atje ku "armikut" nuk i shkonte në mend se mund ta qëllonin. U dha një komandë e re dhe u shkël kronometri.

— Topi në duar, për në pozicion, para! — Dhe krahet e komandantit të topit u ngjeshën të parat pas rrotës. Ai e din se çdo të thotë shëmbëll personal. Për ta ngjitur topin në atë të përpjetë, gjithë gurë, s'pinin ujë fjalët. Duhej gjoks, zemër, forcë ushtari, duhej burrëri. Dhe topi lëvizte, gjithnjë përpara, mbi gurë. E shtynin krahiët e ushtarëve... Tahiri, shënjuesi, rrëshqiti. Kupa e gjurit i takoi mbi gur. Iu duk sikur iu ngul një hekur. I theri. Por gjoksin nga rrota e topit nuk e luajtë e ngjeshi më fort pas saj. Gjithë dhimbja sikur iu kthye në forcë, e rrota iu duk sikur lëvizi më shpejt. Pashku e pa, u bë gati t'i fliste, por s'arriti. Zëri i Tahirit jehoi:

— Edhe një herë, oo-hop!...

Ja edhe pozicioni. Por s'kishte kohë as për të fshirë djersët. Përballë u çfaq "tanku armik". Pashku dha komandat. Tahiri, Dhiokseni të gjithë numurorët, lëviznin me shpejtësi, çdo veprim e kryenin me saktësi. U hap zjarr. "Tanku" i parë u asgjësua. Por menjëherë duart e shkathëta të ushtarëve e drejtuan grykën e topit mbi të dytin, mbi të tretin... Nga ai pozicion, tanket e "armikut" gjetën vdekjen, nga ai pozicion ushtarët që komandon Pashku manifestuan shpirtin e sakrificës, zotësinë dhe përgatitjen e lartë të ushtarit të revolucionit.

Ndoshta të gjitha këto iu kujtuan Pashkut atë çast që treti shikimin andej, në thellësi të maleve. Dhe u desh sa t'ua zije në gojë atë ditë. Të gjithë, sepse u gjallëruan më shumë, të gjithë ruanin në zemër kujtimet më të bukura, më të paharruara.

... Qitja që kishte bërë topi i komanduar nga Pashku i kishte entuziazmuar pa masë. Në ato çaste ishte njoftuar, se disa nga shokët, do të qëndronin në poligon, për të zhvilluar qitje treguese. Në mbrëmje, i tërë kolektivi, i uroi Seitit, Gëzimit, Frrokut, Pashkut, Muhametit, Fadilit, Besimit, suksese, por dhe të kishin mendjen: të ktheheshin në nënrepart me fitore. "Një fitore të re për 25-vjetorin e çlirimit të atdheut — Ja këtë kërkojmë nga ju". — Kështu i porositi kolektivi.

Ky ishte një besim i madh dhe një përgjegjësi e madhe. Po atë mbrëmje, ata u mblodhën pranë një topi. Ishte një mbledhje, që u ngjante atyre që bëheshin gjatë luftës para një beteje. Aty u diskutua rreth një vendimi që kishte marrë kolektivi. Po, porosinë e shokëve ata e quajtën vendim.

— Puna e parë që duhet të bëjmë është çështja e shënjesit. Cili do të jetë? — pyeti komandanti. Ra, për një çast, heshtje. Ata të gjithë zotëronin detyrën e komandantit të topit, të shënjesit, të mbushësit... Të gjithë e kishin plotësuar objektivin për të përvetësuar dy e më tepër detyra.

— Jam gati ta bëj unë — u hodh Fadili.

— Ndërsa unë mendoj për Xhovalinin — foli Seiti.

— Drejt e ke, ti Seit, — ia pritën në një zë Besimi me Muhametin. Dhe kështu u ngjall një diskutim luftarak. Kolektivi vuri në peshë cilësitë e Fadilit dhe të Xhovalinit, mati zotësitë e njerit e të tjetrit me një sy kritik. Xhovalini, është më gjakftohtë, më i sigurtë në vetvete, më i shpejtë dhe më i përpiktë. Në asnjë rast gjatë stërvitjeve, ai s'ka bërë lëshime, është treguar gjithënjë i kujdesëshëm, gjithënjë i vëmëndëshëm në zbatimin e komandave. Po Fadili? Ai është sa mbushës i mirë, aq dhe komandant topi e shenjues i zoti. Por ka patur raste që është ngutur.



— Dakort — thanë të gjithë. Me ta u bashkua dhe Fadili. Në rol të mbushësit u caktua Besimi që kryen detyrën e shënjesit.

Ra nata. Pikërisht gjatë kësaj nate do të ziheshin pozicionet. Topat do të shtyheshin me krahë, nëpër një teren të vështirë. Por s'ka forcë që ta ndalë ushtarin, kur është fjala për të plotësuar detyrën. Bile, ndjenja e detyrës atij ia qindfishon energjinë, e bën të papërkulur, përpara çdo vështirësie e pengese. Dhe pikërisht, edhe atë natë, ata manifestuan vetitë e larta të ushtarit të revolucionit, të ushtarit që ka në zemër, në mendje idealet e partisë, mësimet e saj e të shokut Enver. Ja ku u doli përpara një pengesë, që dukej e pakapërcyeshme: rrugën ua ndërpriste një kodrinë dheu e gurësh. Pozicionet ishin akoma larg. Ato duheshin zënë, atje duheshin vendosur topat.

— Si t'ia bëjmë, shokë? — pyeti komandanti.

Vendimi u mar aty-për aty: të largohej dheu dhe gurët, të çahej rruga!...

Muskujt e ushtarëve u tendosën. Punuan ata një orë, dy, tre... e kush i shënoi! Vetëm dihet se për të larguar atë dhë e ata gurë do të duhesh, në rrethana të tjera, ndoshta dhe një ditë e tërë... Pozicionet ata i zunë në kohën e caktuar. Nga ata pozicione, të nesërmen jehuan komanda dhe krisma, por më fort se çdo gjë rrahu zemra e ushtarit, punoi mendja, dora e shkathët dhe syri i mpredhë i tij. Të gjithë objektivët u asgjësuan, çdo predhë në shenjë! Kjo ishte një fitore e madhe për tërë kolektivin, për secilin nga ata, ishte një dhuratë që ushtarët e popullit ia kushtuan Atdheut në jubileun e lavdishëm, në pranverën e madhe 25-vjeçare.

## MALET RRINË ZGJUAR, MALET VIGJËLOJNË...

— 1 —

Së shpejti do të nisemi, do të takohemi me kufitarët. Rruga që do të bëjmë është e gjatë e vazhdon të bjerë shi. Kohën që na ka mbetur e shfrytëzojmë duke shfletuar historikët e disa postave që i gjejmë në komandë. Në këto e sipër dikush troket në derë. Është një kufitar. Komisar Lleshi i flet në emër, i bën me kokë që të ulet dhe vetë vazhdon të bisedojë në telefon. I zgjasim dorën djaloshit. Ndërkohë mendojmë: "Mos është ky ai Dëfrimi për të cilin na kanë folur?" Vendosim ta sqarojmë çështjen: E pyesim kufitarin për mbiemrin. Përgjigja e tij na gëzon. Komisari e ndërpret në çast bisedën dhe thotë:

— Që këtu fillon takimi me kufitarët.

Po, ky është një takim i prekshëm. Shtrëngimin e dorës së Dëfrimit e ndiejmë për një kohë të gjatë, por i parruar do të na mbetet në kujtesë portreti i tij, portreti i kufitarit të thjeshtë dhe krenar, vazhduesit të denjë të stafetës që kanë dorëzuar breza të tërë kufitarësh...

Ai ishte ndarë nga familja me një mendim të kthjellët, me një piksynim të caktuar. Ai mendim e kish shoqëruar orë dhe ditë të tëra deri në çastin që kishte dalë nga rresh-ti dhe kishte dëgjuar këto fjalë:

— Juve jeni Dëfrimi?

— Po.

— I biri i Fuatit, sigurisht.

— Po, veçse kam një kërkesë, ose më mirë të them një

amanet nga babai. Ai më kishte porositur, që kur ishte gjallë...

Eprori kishte buzëqeshur pastaj i kishte hedhur dorën në sup dhe nuk e kishte lënë ta mbaronte fjalën.

— Shoku Fuat na pat shkruar me kohë për një gjë të tillë. Ne të prisim.

Eh, si i kishte rrahur zemra Dëfrimit në ato çaste, sa ishte gëzuar! Ai s'kishte gjetur dot fjalë se si ta shprehte gëzimin veç ishte kthyer prapa dhe me hap të vendosur kishte zënë vend në rresht. Sytë i shkëlqenin. Për një çast vështrimin e kishte hedhur tej maleve të lartë. "Imat ka shërbyer atje". Kështu i ishte dukur shokut të komandës sikur thoshte në ato çaste Dëfrimi. Prandaj edhe ai i kishte thënë:

— Prgatitu për rrugë. Ajo do të jetë e gjatë. Do të kapërcesh male...

Dhe kapërceu ai male të lartë, gryka e hone e në mbremje, sëbashku me shokët, arriti në postë, atje ku vinte më parë, në të njëjtin vend, kishte qënë i ati.

Efektivi ishte mbledhur dhe Dëfrimi kishte ndjerë që në çastet e para atë ngrohtësi e miqësi kufitare, për të cilin i kishte folur i ati. Për të, ajo postë nuk ishte e panjohur.

Komisari i kishte njohur të porsaardhurit me historikun e postës. Aty flitej edhe për njësitin ku kishte qënë i jati Dëfrimit, për burrërinë e treguar prej tyre në luftë kundër një bande diversantësh. Dhe e kishte lënë me aq.

— Nesër do të shkojmë në vënd, atje ku ka luftuar njësiti — kishte thënë ai.

Dëfrimi mezi e priste ditën e re. Sa dëshirë kishte ai të shkelte atje ku kishte shkelur i ati, të shtrihej në atë pozicion ku kishte luftuar ai, të delte me shërbim në ato shtigje nga kishte shërbyer Fuati! Atë s'po e zinte gjumi.

Dikush fliste. I bëhej sikur dëgjonte zërin e të jatit. "Ec-nim me kujdes. I bënim sytë katër. Po po, në kufi sytë duhen bërë katër. Armiku është i pabesë, dinak... Bاندën diversante e diktuam në kohë e i zumë pritë. Ajo hapi zjarr dhe ne iu përgjigjëm. Vendosëm: Më mirë të vdisnim se sa të lejonim armiqtë të plotësonin qëllimet e tyre. Zjarrin s'e pushova edhe atëhere kur plumbi më dërmoi krahun e djathtë. Shulin e pushkës e hapja me dhëmbë. Krahu s'më punonte. Por në kufi, në front, përballë armikut mjafton të kesh urrejtjen të ndezur, mjafton të kesh besimin dhe i mund armiqtë, sado të jenë ata... Pastaj erdhën shokët. Pozicionet tona ishin skuqur me gjak, por armiqtë s'mundën të kalonin. Ata e paguan shtrenjtë. Nëqoftëse do të shkosh atje, bir, kërkoi, e do t'i gjesh ata pozicione...".

Të nesërmen, me në krye komisarin, kufitarët ishin nisur për atje ku kishte luftuar njësitit, për atje ku ndodhe-shin pozicionet e larë me gjak. Përpara lapidarit, komi-sari kishte treguar me hollësi ngjarjen. Pastaj, Dëfrimi, duke sjellë në mend porosinë: "Kërkoi e do t'i gjesh ata pozicione...", sëbashku me shokët, jo vetëm shkeli në to, por edhe u shtri. Të gjithëve atyre u dukej, sikur atë ditë e takuan e biseduan edhe me të jatit e Dëfrimit. Në ditët e netët që erdhën më pas, Dëfrimi e shokët e tij kanë kaluar shpesh andej me pushkët shtrenguar. Ndosh-ta dhe atë natë, që kufitarët do të festojnë jubileun e lav-dishëm të forcave të kufirit, Dëfrimi, në përbërje të një-sitit, do të kalojë pranë atij lapidari, në ata pozicione.

Pas pak u ndamë me Dëfrimin dhe u nisëm për të ta-kuar kufitarë të tjerë, bij të tjerë të popullit.

— 2 —

Në postën "N" arritëm von. Kufitarët i gjetëm të en-tusiazmuar. Ky shprehej në fytyrat, në sytë dhe në bisedat

e tyre. Nuk e patëm të vështirë të mësonim arësyen e këtij gëzimi. Ata sapo kishin dalë nga një mbledhje, ku sekretari i organizatës bazë të partisë, shoku Mëhill, u kishte dorëzuar flamurin tranzitor të garave socialiste në kuadrin e 25 vjetorit të Forcave të Kufirit. Dy kufitarë, atë flamur e kishin vendosur në ballë të dhomës së kulturës e pastaj kishin thënë:

— T'i ngulim mirë gozhdat, që të mos na ikë asnjëherë nga duart flamuri.

Shokët kishin qeshur, por pasi ishte vendosur qetësia, dikush kishte thënë:

— Atë do ta mbajë puna jonë dhe jo gozhdat!

Këtë mendim të kufitarit e kishte përkrahur dhe shoku Mëhill, i cili u kishte kujtuar se edhe të tjerët punonin me nerva të tendosura, luftonin, arrinin suksese dhe kishin me çfar ta meritonin flamurin tranzitor.

— Kini "rivalë" të fortë, mos e harroni këtë — u kishte thënë ai.

Ndoshta këto fjalë i bënë kufitarët të mendoheshin, për të mos rënë në vetkënaqësi, por nuk e prekën aspak atmosferën e gëzueshme të fitores së arritur me djersë e mund, me përpjekje e sakrificë. Përkundrazi ato sikur e rritën më tepër vendosmërinë...

Kështu, pra, fillimin e vet biseda jonë me kufitarët e kësaj poste, e pati me ngjarjen më të rëndësishme të asaj dite, marrjen e flamurit. Por na u desh të pyesnim shumë, të "rëmonim" në kujtesat e kufitarëve për t'u shkitur diçka më tepër nga jeta në kufi. Se është vështirë me këta djem të thjeshtë! U duket gjithçka e zakonëshme dhe gjithçka e përmbledhin në pak fjalë. Edhe për një akt të lartë heroizmi, atyre sikur u mungojnë fjalët, edhe për sakrificë më të madhe ata të thonë me thjeshtësinë kufitare: "Bëmë detyrën"! Nëqoftëse dikush do të zbulojë rrenjët e këtij tipari karakteristik të kufitarëve, ai duhet

të njohë jetën e tyre. E jeta në kufi është e tillë, ku heroizmi, sakrifica, guximi, qëndrueshmëria, korrektësia, gjithçka e lartë që përbën figurën morale të kufitarit është shkruar në një të vetme, në ndjenjën e përgjegjësisë ndaj detyrës së shenjtë të ruajtjes dhe mbrojtjes së kufirit. E kjo ndjenjë përbën moton e jetës kufitare. Këtu buron dhe thjeshtësia, madhështia dhe krenaria kufitare, këtu, në këtë ndjenjë të lartë, që ka kultivuar partia në breza të tërë kufitarësh, qëndron dhe heroika kufitare.

I kemi përballë Xhaferin e Laverin. I pyesim, se duam të mësojmë diçka nga jeta e puna e tyre në kufi. Ata ulin kryet, qëndrojnë si në gjëmba. Kur vjen fjala për një shokun e tyre, që s'kishte treguar se i ishin enjtur këmbët, vetëm e vetëm që të mos ndahej nga të tjerët në shërbim, ata sikur marrin zjarr, ndërpresin dhe njeri-tjetrin. Por edhe këtu ata mbajnë "rezerva". Nuk përpiqen ta mburin shokun, por zbulojnë motivet që e shtynë atë të bëjë këtë ose atë veprim. Kjo është një cilësi e bukur e kufitarëve! Ndoshta këtu e ka zanafillën edhe ajo shoqëria e ngushtë për të cilën mburret çdo njeri që e quan veten kufitar. Dhe na treguan një rast:

— Shoqëria jonë është luftarake se kalitet në kushte luftarake. Seferi u shëmur pa prituri gjatë shërbimit. Ç'bënë shokët e tij? Xhaferi dhe Laveri, mënjanë çanin dëborën deri në brez, i bënë ballë tufanit mbanin në krahë edhe atë, shokun vëllanë e tyre. Por kjo ishte njëra anë. Ana tjetër, më kryesorja ishte se me shokun në krahë, ata s'e humbën asnjë çast vigjilencën. Vetë Seferi mbështetur mbi supet e tyre, herë pas here, i kujtonte: "Shokë, kujdes, mos harroni detyrën!"...

Ata u vonuan e të gjithë në postë u shqetësuan. U nisëm disa prej nesh midis tufanit të egër. I gjetëm. Po ktheheshin me shokun në krahë. Dëborë dhe tufani u kishte marrë shumë forca, por jo besimin se do të fitonin. Krahet e tyre ia shpëtuan jetën shokut".



Por ne kemi shumë syresh përpara dhe secili mund të na thotë shumë gjëra. Por ç'e do. Ata janë fjalë pak. Përsëri kthehemi tek ngjarja e ditës, tek flamuri, e biseda vërtitet rreth jetës kufitare. Dalngadalë, ajo sikur zbulon kraharorë. Eh, ç'visare ka kjo jetë kufitare!

... Njësitin e komandonte Zoi. Para se të niseshin, komandanti u kishte thënë: "Kujdes, sot ka rënë dëborë!". Kasëmi u çudit, por Zoi, si të kishte kuptuar mendimin e kufitarit me më pak përvojë, kur dolën nga zyra i tha:

— Dëbora, që sapo ka rënë, kërcet prandaj të kemi mendjen. Nga ana tjetër, ajo mbulon gjurmët e vjetra, prandaj t'i hapim mirë sytë.

Kasëmi s'e harroi porosinë. Çdo hap e hidhte me kujdes, në çdo hap vrojtonte, përgjonte. Ja, ai ndaloi. Dëbora sikur kishte lëvizur. Mos ishte gjurmë? U përkul pak. Po, gjurmë! Dha sinjalin. Përgjegjësi i njësitit ishte afruar. Kasëmi ishte treguar vigjilent. U bllokua vija e kufirit. Në ndjekje të gjurmës u vu Ademi me "Mollën" e tij të shpejtë e kufitarë të tjerë. Pas pak në errësirën dhe qetësinë e natës u ndje, si bubullimë e fortë, një zë:

— Ndall!

Jehona e këtij zëri u përcuall grykave e honevë. Malet rrinin zgjuar, në male vigjilonin! Ja ku i kemi përpara: kufitarët tanë dhe malet tona. Ja ku është Haxhiu, Petrefi e Seferi, ai që mori jetë nga supet e shokëve. Sa të thjesh-të, aq dhe të rreptë ndaj armiqve, ndaj atyre që duan të prishin qetësinë e këtyre maleve. E shtrëngojnë fort pushkën ndër duar, çajnë në errësirën, kapin çdo zhurmë, ndjejnë çdo lëvizje. Po, çdo zhurmë, sa do e vogël që të jetë. Jeta në kufi i ka stërvitur për çdo rast. Dhe ja, Seferi e kap një zhurmë. Ajo si vjen mirë në vesh — është degë peme, lëvizje guri, hapa njeriu, kafshë të egër apo... Sidoqoftë është një zhurmë, që vlerësohet nga kufitari, që ia rrit më tepër vigjilencën, gadishmërinë. Njësitin vi-

het në dijëni për këtë, merren masa dhe s'kalon shumë kohë, çdo gjë sqarohet. Pas thirrjes luftarake: "Ndal", përpara kufitarëve dikush ngre duart. Është një shkelës. Ai s'i shpëtoi dot vigjilencës së kufitarëve...

Të nesërmen, një pjesë e kufitarëve, u nda në dy grupe, që u nisën në dy drejtime, drejt dy lapidarëve, për t'i përfunduar sa më parë. Në prag të jubileut ata do të inaugurohen. Me këta dy lapidarë ata do të përjetësojnë veprën e dy paraardhësve të tyre kufitarë: të Shyqyri Myslimit dhe Idriz Abdylit që u përlëshën me armiqtë, qëndruan si shkëmb dhe dhanë jetën, këtu në vijën e kufirit. E mbrojtën këtë truall me gjakun e tyre. E gjaku i derdhur për çlirimin, mbrojtjen e ndërtimin e Shqipërisë, s'mund të bëhet ujë, ai ka çimentuar themelet e Atdheut. Në roje janë bijtë e shqipes, janë kufitarët!

— 3 —

Komisar Lleshi, edhe pse bie shi e rruga është tërë balte, s'pushon së foluri. Ai di aq shumë për jetën kufitare, për njerëzit që shërbejnë në repartin ku ai bën pjesë, sa nuk mund të besosh se vetë ai është i ri në forcat e kufirit. Ai këtë e shpjegon me detyrën që kryen, me kërkësat e saj, për të mësuar gjithçka e për t'i përdorur këto dije për punën edukative me njerëzit. Kjo është e drejta. Por ka dhe diçka tjetër: jeta në kufi është e mbushur me ngjarje, ndodhira, heroizma e sakrifica, me të cilat ndeshesh çdo ditë, orë e çast. Ato e frymëzojnë, e mbushin plot forca e pasion komisarin e secilin kufitar.

Takojmë Arifin, një kufitar i vjetër e me përvojë. I gjatë, shpatullgjërë, me shikim të mprehtë është Arifi. Krahët e tij duken si degë lisi. Por sa i thjeshtë e i përzemërt është në bisedë! Ai skuqet kur duhet të flasë për veten e tij, për detyrën që kryen.

— Lermëni mua, kemi djem të tjerë të zotë këtu në kufi. Ai na numuron shumë syresh e, për secilin, tregon një episod, një ngjarje.

— I kam mësuar prej gojës së shokëve që shërbejnë me ta — thotë ai si për t'u dhënë më vërtetësi atyre që tregon.

Detyra që ai kryen si armëtar, e lidh shumë ngushtë me kufitarët. Por nguron të na tregojë, se, pikërisht për punën që bën, për gadishmërinë e lartë, për ndërgjegjen e tij prej komunisti revolucionar, është dekoruar. Kur ia përmëndim këtë, krahu i tij, si degë lisi, lëviz në drejtim të një poste:

— Edhe atje kini të dekoruar.

— 4 —

Për të shkuar deri atje ku na tha Arifi na duhet kohë, ndoshta edhe një ditë. S'na pritet dhe kërkojmë nga Lleshi të na tregojë. Komisari mendohet një hop dhe fillon:

— Ndodhi kështu: në postë kishin ardhur kufitarë të rinj. Ata janë të etur të dinë e të mësojnë çdo gjë sa më shpejt. Ganiu ishte mjaft i zënë me punë dhe nuk dëgjoi kur një nga kufitarët u tha shokëve të rinj: "Kujdestari është kufitar i vjetër i dekoruar me urdhërin e trimërisë. Ndonjë ditë vetë ai do t'ua tregojë ngjarjen...". Kureshtja nuk i la kufitarët të prisnin shumë kohë. Kur Ganiu ishte bërë gati të shkonte në shtëpi, njeri prej tyre, pak i ndrojtur i kishte thënë: "Po të presim..." Ganiu ishte zënë ngushtë. T'u tregonte për veten e tij? Po thjeshtësia kufitare? Pasi ishte menduar, i ishte përgjigjur: "Një ditë tjetër. Por kufitari nuk ishte larguar. Kur pa se atë e kishin rrethuar edhe shumë shokë të tjerë, mori zemër dhe ia përsëriti kërkesën: "Dëshirojmë t'u dëgjojmë sot".

Kështu ata u futën në klasë dhe mësuan se kujdestari i postës së tyre, Ganiu, gjatë asgjësimit të një bande kriminelësh kishte treguar guxim, zgjuarësi e trimëri, të kultivuar këto gjatë shërbimit në kufi. Ai i ishte afuar strofkullës së kriminelëve shumë pranë, së bashku me qenin dhe kishte hapur zjarr. Kriminelët kishin ndjerë rrezikun, prandaj e përqëndruan zjarrin mbi kufitarin dhe qenin e tij. Në një çast, pranë tij, ra një granatë. Me shpejtësi të rrufeshme e kishte rrëmbyer granatën e kriminelëve dhe ua kishte vërvitur atyre. Ajo kishte shpërthyer e me gjëmimin e saj ishin përzierë dhe ulurima...” Ja, kjo është e gjithë” kishte thënë në fund Ganiu. Kufitarët qëndruan akoma në klasë, me përshtypjet e mbresat e thella që u kishte lënë tregimi i kujdestarit.

— 5 —

Sapo i afrohesh postës të bie në sy dora e kujdesëshme e kufitarit për të krijuar, edhe në këtë kënd malor, një ambjent të kultivuar. Përpara ndërtesës, majë një direku të lartë çpaloset flamuri kombëtar. Fërfëritja e tij i shoqëron kufitarët edhe në netët e errëta kur nisen me shërbim. Ai i jep solemnitet ambjentit luftarak të postës, u “flet” shumë kufitarëve, u kujton historinë e shkruar me gjak e sakrifica e të mbushur plot lavdi e heroizëm.

Pasditeve, kufitarët grumbullohen shpesh përpara ndërtesës dhe, në vendin e rrethuar me plisa, nën fërfëritjen e palëve të flamurit, ia marrin këngës, këngë që jehon deri në thellësi të maleve e që mbush qiellin. Me afërsimin e jubileut këto këngë marrin një notë më të fortë, dëgjohej më shpesh. Këngët e bukura që i kushtohen partisë, forcave të kufitarit, jetës kufitare i këndojnë të gjithë. Një pjesë i kanë thurur vetë kufitarët.

Jeta e pasur kulturalo-artistike që zhvillohet në këtë

postë hedh dritë mbi vetë pasurinë shpirtërore të kufitarëve. Ata janë sa të gatëshëm e vigjilentë, sa trima e të guximëshëm, aqë dhe njerëz me priirje, dëshira, fantazi të ndezur e shpirt krijues. Midis këtyre maleve gumëzhin **bota e pasur e njerëzve tanë të rinj.**

Në dhomën e kulturës takojmë Lulëzimin, një kufitar i dalluar në të gjitha drejtimet. Ai na flet për kujdesin që tregohet për freskimin e materialit figurativ të dhomës për këndin e 25-vjetorit të forcave të kufirit. Por temat më të dashura për të, me sa kuptohet, janë ato mbi librin, mbi grupin artistik të postës.

— Çdo libër i ri që del, merr rrugët e maleve — na thotë Lulëzimi me krenari. Bukur u shpreh! Në ballë të këtyre librave qëndrojnë Historia e Partisë dhe veprat e shokut Enver, qëndrojnë të gjitha materialet e partisë e libra të tjera politike. Lulëzimi bën një llogari të thjeshtë e na tregon:

— Gjatë një muaji kufitarët kanë lexuar 24 libra, nga këto 14 politike e pjesa tjetër artistike e shkencore. Vetëm kohët e fundit bibliotekës sonë iu shtuan 11 libra të reja. Kështu, ne tashmë kemi mbi 140 libra. Kjo është një pasuri e madhe me vlerë të pallogaritëshme edukative. Tek ne nuk bëhen vetëm lexime. Herë pas here, në orët e pasditës, pikërisht në këtë dhomë, shokët tanë si Resmiu, Tomorri, Isaj e shumë të tjerë, bëjnë recensionë, organizojnë diskutime si të mësojnë e çfarë të mësojnë nga librat...

Por Lulëzimi nuk do që të kufizohet vetëm në këtë aspekt të jetës në postë. Ai dëshiron të na tregojë edhe për grupin artistik, për programin që ka përgatitur ai me rastin e jubileut, për turneun e zhvilluar pak kohë më **parë në postat e fshatrat fqinj. Pjesët e programit i kanë shkruar vetë kufitarët, prandaj programi përmban copëza nga jeta e postës së tyre. Shtëpi: "Kapja e thyesit", e ka shkruar Lulëzimi, "Servilin", Resmiu, "Guzhinjeri"**



një shok tjetër e kështu me radhë.

— Po heroizmin kufitar si e pasqyroni në program? - pyet komisari.

— Heroizmin kufitar? Tërë programin e përshkon, si fill i kuq, ky virtyt i lartë i kufitarëve. Në të flitet edhe për kujdestarin tonë.

Kështu u njohëm për së afërmi edhe me Ganiun që arriti atë çast, për të cilin na kishte treguar komisari gjatë rrugëtimit.

— 6 —

Ecim nëpër kufi, nëpër këto male të lartë dhe na duket sikur ndjejmë tërë frymëmarrjen e Atdheut. Po, pulsi i kufitarëve reh njësh me atë të të gjithë popullit. Ata ruajnë popullin e burimin e fuqisë e kanë tek populli. Kur bëhet fjalë për jetën kufitare ajo merret e pashkëputur nga populli që rri zgjuar, që punon e vigjëlton bashkë me bijt e tij. Në një postë, në një orë të natës u dha alarmi në kufi. Binte dëborë e ulurinte tufani, por kushtrimi u përcuall në çdo vatër. S'kaloi shumë kohë e përmes errësirës e tufanit vraponin njerëzit, vraponte populli, me pushkët në krahë për të mbrojtur kufirin, çdo pëllëmbë të tokës së lashtë. Si arritën në postë Beliu, Rustemi, Haxhiu e dhjetra të tjerë, 70-vjeçari Brahim tha:

— Na caktoni vendet shoku komandant!

Dhe kooperativistët i zunë pozicionet bashkë me kufitarët. Përkrah njeri tjetrit ata e ndejnë veten gjithënjë të fortë, si malet. Ata janë pjesë e tyre, shkëmbinj në gji të tyre.

Në afërsi të postës kufitare ndodhet dhe një ndërtesë tjetër. Në të banojnë familjet e ushtarakëve. Jo vetëm pse është afër postës mund ta quash pjesë të saj, por sepse familjet e ushtarakëve, gratë e fëmijët e tyre e quajnë veten kufitarë. Jeta e këtyre familjeve është pjesë e pandarë e jetës kufitare.

...Ishte e djelë dhe Hurma Beqirin e gjetëm në shtëpi.

Po të ishte ditë tjetër s'do t'ia kishim arritur qëllimit. Vërtet posta e tyre (kështu e quan ajo) është e futur midis maleve, por Hurmaja s'është nga ato që të rrijë e mbyllur, të gatuajë e të fshijë shtëpinë, të presë e të përcjellë mysafirë. Atë e gjen vazhdimisht në arat e kooperativës që kanë në afërsi, e gjen midis grave e vajzave punëtore, atje ku mbillen e hapen tokat e reja, në vatrën e kulturës, apo në shtëpinë e tyre e me punën e saj si agjitate e propagandiste e flaktë e partisë, merret me edukimin e tyre, me revolucionarizimin e ndërgjegjes, me luftën kundër çdo koncepteve të huaj e konservator, kundër çdo zakoni prapanik që është ruajtur akoma në disa njerëz midis këtyre maleve të lartë.

Por atë ditë, zëvendës sekretarja e organizatës bazë të partisë së kooperativës, Hurmaja, nuk kishte dalë nga shtëpia, përkundrazi ishte marrë mjaft me problemet e shtëpisë. Ajo priste t'i vinin disa shoqe kooperativiste për të biseduar se si mbahet më mirë rregulli e pastërtia në shtëpi, si krijohet në familje një ambient i kulturuar e i ngrohtë, një atmosferë e gëzueshme. Ato duhej të mësonin nga Hurmaja edhe në këtë drejtim ajo e konsideron këtë një detyrë të rëndësishme, aq më tepër se është një grua komuniste, grua ushtaraku.

Hurmaja po mbush afro dy dekada jetë kufitare. Fëmijët e saj, një djalë dhe një vajzë, vetë ajo, në të folurit, shqiptojnë fjalë të shumë dialekteve dhe s'është vështirë të marrësh vesh rrugën që kanë bërë, krahinat ku kanë qënë. Por kudo ajo ka lënë mbresa, sepse kudo ka qënë një punëtore e palodhur, një kufitare vigjilente, një aktiviste e dalluar shoqërore, kudo ka mbajtur lart emrin e komunistes. Ajo thotë: "Kufiri, jeta në kufi, na ka hyrë në gjak. Me të po rriten bijtë e bijat tona, breza kufitarësh!"

Këto fjalë të Hurmasë u përsëritën në mbrëmjen e asaj dite edhe në familjen e Goxhos e Islamit i përsëriti Beneja me Gjylen, që kanë nga një tufë fëmijësh plot shëndet, të



cilët u luten shpesh kufitarëve t'i lenë të prekin pushkët, apo të provojnë kapelet e tyre. Dhe kur kjo dëshirë u plotësohet, fëmijët gëzohen, flenë me ëndrrën e bukur se kur do të rriten do të bëhen kufitarë të vërtetë. "Në kufi lindën, kufitarë do të bëhen dhe s'ka më mirë. Ata po mësohen që tani të bëjnë gjumin me copa, që tani e pyesin të jatin: "E, babi, ç'kemi nga vija e kufirit!" — thotë Beneja.

Në qoftëse atë ditë Hurmaja priste kooperativistët, Beneja me Gjylen prisnin një mësuese, drejtoreshën e shkollës 8-vjeçare. Por ajo po vonohej dhe të dyja gratë shprehën shqetësimin: "Kushedi ç'punë i ka dalë." Ato nuk e dinin se Leonora Heroina e Punës Socialiste, ajo që me inisiativë la Fierin dhe erdhi në këto male si komisare e kuqe e dritës, e dritës së partisë, kishte arritur në postë dhe bisedonte me kufitarët. Ata nuk e dinin se Leonora me rastin e jubileut të Forcave të Kufirit, kishte ardhur në postë për të koordinuar planin e aktiviteteve të përbashkëta, për t'u takuar me shokët që do të shkonin në shkollë për t'u treguar nxënësve ngjarje dhe episode nga kufiri. Por ato e dinin me siguri, se ajo do ta mbante fjalën, do të shkonte edhe në familjet e ushtarakëve.

Dhe Leonora qëndroi atë natë në gjirin e familjeve kufitare, provoi dashurinë, respektin, mikpritjen kufitare...

Natën ra shi. Ai s'pushoi as tërë mëngjezin.

Në afërsi të postës, midis shiut, qëndron në këmbë komisar Goxhua. Ai i ka ngulur sytë rrëzë kodrës. Andej kalon rruga për në shkollën e fshatit. Në atë rrugë ecën një vajzë dhe katër fëmijë. Dy nga ata, vajza i ka futur nën pardesy, për t'i mbrojtur nga shiu.

"Iku, thotë komisar, iku për të filluar ditën e re në shkollë. Ajo mori me vete edhe fëmijët tanë, kufitarët e arëdhëshëm. Ata s'do ta harrojnë mësuesen e tyre heroinë, edhe atëhere kur do të qëndrojnë roje pranë piramidave...

## ATJE SHKRUHET POEZIA MË E BUKUR, MË BURRËRORE

Në postën kufitare "N" arritëm pasdite. Ajo ndodhet midis malesh të lartë. Ndaj dhe ndërtesën e postës, kur e shikon nga larg, të duket si një copë shkëmb i bardhë. Në afërsi të saj, kufitarët kanë shkruar një parullë: "25 vjet". Edhe ajo të duket si e gdhëndur në shkëmb. Por jo. Kufitarët i kanë marrë shkëmbit vetëm gurë të vegjël, i kanë lyer me gërçe dhe kanë shkruar atë parullë. Ndërsa në të vërtetë si të gdhëndur do ta gjesh jubileun në çdo zemër kufitari.

Për jubileun mendon, punon dhe krijon secili, për të kufitarët thurin dhe këngë. Kërko të takosh Markun apo Asllanin, Xhezmiun apo Prengën, në një orë pushimi. Edhe komandanti edhe shokët e tyre të thonë: "Po afron koha të dorëzojnë poezitë kushtuar jubileut, kushëdi ku mund të jenë futur. Qënka vështirë të shkruash... "Me këto fjalë u nisëm për në dhomën e kulturës. "Ndoshta ndonjerin e gjejmë aty", - thamë. Dhe gjetëm Xhezmiun. Rrinte pranë dritares dhe provonte melodinë e një kënge në telat e çiftelisë. Ai ka marrë zotim që gjatë shërbimit në kufi ta mësojë këtë instrument karakteristik të zonave të veriut. Vetë është nga Berati.

— A e mbarove poezinë, Xhezmi?, - i foli dikush kur u futëm në dhomën e kulturës. Kufitari uli çiftelinë.

dhe u mat të përgjigjej por në këtë kohë komandanti iu afrua një stende dhe foli:

— Ja, njihuni me krijimet e kufitarëve për partinë dhe shokun Enver. Ai lexoi:

Zemra më digjet, se dua të shkruaj,  
Dy vargje të thjeshtë, për ty shoku Enver  
Këtu, pranë piramidës, kufirin unë ruaj  
Mësimet e partisë-ne kemi fener...

Xhezmiu dëgjonte në heshtje dhe të dukej sikur në këto çaste ndjenjat e tij të zjarrta merrnin me zjarr. Pas pak u largua. Diku shkoi, ose të vazhdonte t'i binte çiftelisë, sepse kështu kënga për partinë do të tingëllonte më e bukur, ose do të përfundonte poezinë për jubileun, nga e cila shkëputëm këto vargje:

Kur dal në vrojtim  
Unë ndjej krenari  
Se mbroj vendin tim  
Të fortën Shqipëri!

Dhe kështu u këndojnë atje të gjithë kufitarët partisë, shokut Enver, Atdheut, u këndojnë thjeshtë, por me zemra të mbushura plot dashuri. E me këto këngë në gji ata nisen maleve të lartë, më të fortë e më të vendosur më të gatshëm e më vigjilentë.

Qëndrojmë akoma në dhomën e kulturës. Edhe ajo bën pjesë në jetën e kufitarëve, edhe aty rreh puls i tyre edhe aty ndjen se sa fort i ka pushtuar zemrat e kufitarëve ky jubile i madh i çlirimit. Çdo gjë aty e kanë bërë kufitarët, e kanë ngritur dhe shkruar me duart e tyre. Çdo gjë aty flet për jubileun. Ja një fotografi interesante: një grup kufitarësh kanë rrethuar një shokun e tyre, sekretarin e organizatës së rinisë së pikës, Markun. Aty ndodhet dhe komandanti, Leka. Ai i drejtohet Markut me këto fjalë: "Ndize një herë o Mark, e na trego, ç'ndryshime ka bërë Mirdita jote këto 25 vjetë jete të

lirë?”. Dhe Marku i përgjigjet: “Bash për zemre ma ke gjetun muhabetin, shoku komandant!... Tash po filloj, po mos u mërzitni se kjo është një punë e gjatë...” Dhe atë pasdite, Marku u kishte folur shokëve për Mirditën e tij, për ndryshimet e saj gjatë 25 vjetëve, për heroizmin e guximin e malësorëve, për Bardhok Bibën e Ndrec Ndue Gjokën, për dritën që ka çuar e çon partia ndër ato male, duke fshirë nga faqja e dheut një herë e përgjithmonë errësirën, zakonet e ligjet kanunore”. E të tana këto, shokë, i kena nga Partia e shoku Enver, i kena gjatë këtij çerek shekulli, historinë e të cilit po e studjojmë nëpërmjet Historisë së Partisë e veprave të udhëheqësit tonë të dashur... E tash, par se me marr shërbimin, apo ja themi një herë, o Fadil?...” Pas këtyre fjalëve të Markut kishte jehuar kënga, ajo këngë që del me aqë afsh e zjarr nga zemrat e kufitarëve, kënga për partinë.

Kufitarët një nga një grumbullohen në dhomën e kulturës. Dikush afrohet tek tavolina që është në krye. Merr një nga fletoret që është atje dhe nis të lexojë. Pastaj ajo kalon në duar të tjera. Dhe secili i çfleton faqet me kujdes, lexon dhe mendohet një hop. Në atë fletore ruhën kujtimet e shokëve paraardhës, të atyre që kanë shërbyer aty dhe janë liruar. Aty ata kanë lënë shënime, mbresa, përshtypje, porosi. Kufitarët i kanë caktuar detyrë vetes, që gjatë këtij viti jubilar, herë pas herë, t'i lexojnë ato ç'ka kanë shkruar shokët, sepse kështu u duket sikur i kanë gjithnjë pranë, gjithnjë sikur dalin me ta në shërbim, bisedojnë, ia thonë edhe këngës.

Nga ajo fletore shkëputën disa fragmente. Ja si shkruan ish kufitar Hyseni: “Kur erdha këtu në postë, rruga m'u duk e gjatë. Atëhere binte shumë dëborë. Ndjenja një gëzim të papërshkruar, por edhe padurim. Nuk më pritej sa të shikoja vijën e kufirit, sa të merr-

ja në dorë pushkën me të cilën do të delnja në shërbim. Koha që kalova këtu është një thesar i vërtetë. Këtu gradualisht u paisa me një qëndrueshmëri të çuditëshme e vullnet të fortë... E përsëris: Gjëja më e bukur, më madhështore që më ka ngelur në kujtesë, e s'do ta harroj kurrë janë çastet kur shërbeja në vijën e kufirit, pranë piramidës. Ç'detyrë të lartë që më kishte ngarkuar Atdheu!”

Të gjitha shënimet janë shkruar me një gjuhë të thjeshtë, por përmbajnë një forcë të madhe, që lenë gjurmë. Ja si shprehet ish kufitar Qerimi: “Kur erdha në fillim, nuk më hiqej nga mendja fshati im i dashur. Gjithnjë thosha, se kur do të vinte ajo kohë që kthëhesha përsëri atje. E kjo kohë erdhi, por kam të tjera mendime: Edhe posta ku kam shërbyer ka qënë një pjesë e fshatit tim. E kam shumë të vështirë të ndahem prej saj... Sytë s'i heq nga vija e kufirit...” Ndërsa ish kufitar Halili shkruan: “Largohem me trup, por me zemër e mendje ngelem përherë këtu në postën e dashur kufitare”. Ish kufitar Metja, nëpërmjet shënimeve që ka lënë, zotohet se “gjërat që mësova këtu, do t'i çoj edhe në fshat, që edhe atje të jem një luftëtar i denjë i Atdheut”. Një shok tjetër, ish kufitar Myftari vë në dukje: “Edhe në këto çaste që po largohem e ndjej kujdesin tuaj, të dashur shokë dhe eprorë. Ju më kini mësuar si të punoj, si të silllem në shoqëri, si të bëhem përçues i së resë në fshat. U premtoj se porositë tuaja s'do t'i harroj”. Në pak rreshta, ish kufitar Minaj shpreh ato që ndjen në zemër: “Këtu, në pikë, në sajë të durimit e këmbënguljes suaj unë largova nga vetja shumë mbeturina të huaja. Pra, po iki jo siç erdha...”

Kufitarët, duke lexuar shënimet që kanë lënë shokët paraardhës nxjerrin mësimet e detyra, që t'i ngrejnë më lart, t'i zhvillojnë më tej traditat e postës së tyre. Dhe më-

suam atje, se si ata, në këtë vit jubilar kanë ecur dhe ecin gjithënjë përpara, mbi të gjitha në drejtim të kalitjes më tej të ndërgjegjes revolucionare.

Atë fletore ia pamë në dorë dhe Prengës. Ai ndaloj në atë faqe ku ndodhen ato pak rreshta të ish kufitar Minajt. Na u duk sikur përsëriti me vete: "Po, i dashur Mina. Edhe unë e ndjej se s'jam ai që isha... Këtë ma ka thënë një ditë komandanti, edhe shokët, bile kjo është e shkruar dhe këtu, në dhomën e kulturës, në stendën që kemi ngritur në kuadrin e jubileut..." Na u duk sikur Prenga ra në mendime, sikur kujtonte ditët e javët e para...

Prenga erdhi nga Kashnjeti i largët me një tok mendimesh prapanike, të huaja, që iu bënë ferrë, që e pengonin në çdo hap që bënte. S'pranonte njeri Prenga që ta kritikonte, se, siç thoshte: "Unë kështu di, kështu bëj", ose "ç'ka kini, hej burra me mua, ani se gabova, ç'u banna juve?". Dhe nxehej e prekej shpejt ky Prenga, bile dhe grindej me shokët, qëllonte që vinte në diskutim dhe urdhërat, ndonjëherë edhe shërbimin e kryente me mungesa. Shkaku? Në ndërgjegje ai ruante mbeturina. Pra kishte nevojë për një "mjekim" rrënjësor. Dhe këtë duhet ta bënin shokët, komunisti Leka, organizata e BRPSH, duhej ta bënin me takt, me durim, me këmbëngulje dhe me guxim.

Një herë në mbledhjen e organizatës kritikohej rreptë në referatin e byrosë. U skuq. Vendi s'po e zinte. Pastaj, si e kritikuan dhe shokët, kish brofur Prenga në këmbë dhe kishte folur rrëmbyer. Por shokët diç ndjenë, diç kuptuan në atë rrëmbim. Ai të paktën po kuptonte, se kur gabon, shoku nuk të mbron, por ta thotë të vërtetën në sy e ti duhet ta dëgjosh atë, të mësosh nga kritika e tij, t'i bësh vetëkontroll ndërgjegjes.

Sekretari dhe anëtarët e byrosë së organizatës së rini-

së, gjithë shokët e veçanërisht komunist Leka e ndjenë nevojën për ta mbajtur më afër Prengën, për ta ndihmuar, para së gjithash për ta mësuar atë të studjonte, te thellohej, të nxirrte detyra nga Historia e Partisë e veprat e shokut Enver. Pikërisht këtej u fillua puna me të. Kështu, Prenga nisi të studjojë statutin e BRPSH, letrat që shoku Enver ka shkëmbyer me popullin materiale nga të Kongresit të 5-të të Partisë e të BRPSH.

Një ditë ai thia: "Due dhe Historinë e Partisë, due ta kem timen, ta kem orë e çast me vedi". Shokët u përpoqën që Prengës t'ia siguronin një kopje por s'arritën. Kësaj pune i doli vetë mbanë. Atë ditë që u kthye nga qyteti me Historinë e Partisë në dorë, atë s'mund ta përmbaje dot. Ishte shumë i gëzuar, gëzimi që u kthye në një pasion të madh për t'iu futur studimit.

Kaluan javë. Dy herë rresht Prenga u foli shokëve mbi ato çka studjonte nga Historia e Partisë. Nisi kështu të aktivizohet, të thyepte dhe konceptin: "Ku di unë me fol, hej burra", nisi dhe të mbante qëndrim ndaj gabimeve të të tjerëve, duke thyer kështu konceptin: "Ç'ka po të duhet ty me tjetrin? Lereni në punë të vetë!" Kështu, njëherë Sabriu, ai që e kishte marrë në kujdestari, gjatë shërbimit duke u treguar i pakujdesëshëm, shkaktoi një zhurmë. Kur njësitë ishte kthyer, Prenga i kishte thënë: "S'bane mirë, Sabri, që bisedove me za të naltë. A e din si thuhet në instruksion?..."

Duke qënë nën kudhrën e kolektivit ai theu edhe një tjetër koncept: "Pse me i qit telashe vedit me propozime? Ka kush mendon për shërbimin!" Por ja, dalëngadalë, ai filloi të ndjente përgjegjësinë e madhe që i ishte ngarkuar, filloi të mendojë e të propozojë: "Kam studjue



sektorin në pikën... Vendi atje është i vështirë për shërbim, por kam konstatuar se është i përshtatshëm për kalim. A nuk do të ishte e drejtë me çue edhe atje njësit? - kështu foli një ditë para kolektivit. Shokët tregojnë dhe këtë rast: Islami ishte caktuar të shkonte deri te kufitarët fqinj dhe të çonte disa materiale. Rruga ishte e keqe, binte dëborë. "Ku i çoj dot unë këto?... — kishte thënë. Në atë kohë ishte hedhur Prenga: "A ka gja që s'ban kufitari?... Qëndro ti Islam se po shkoj unë!" Dhe ishte nisur. Në këtë mënyrë ai tregoi se kishte çrrënjësuar e flakur tej konceptin që kishte manifestuar kohë më parë se "të tana sa thuhet s'bahen dot!..."

Biseduam gjatë me Prengën dhe shokët e tij dhe ata thonë: "Ka ndryshuar Prenga. Ndërgjegja e tij është revolucionarizuar. Të gjithë ne jemi revolucionarizuar, e burimi i këtij hopi që kemi bërë janë mësimet e Partisë e të shokut Enver. Kjo duket në sukseset që kemi arritur, mbi të gjitha në gadishmërinë tonë të lartë për të mbrojtur e ruajtur këtë truall, Atdheun e dashur!"

Ja një fakt kuptimplot: po në dhomën e kulturës ndodhet dhe një fletore tjetër: ajo e vrejtyeve dhe propozimeve. Dhe në qoftëse e hap atë fletore, do të duket sikur e prek me dorë preokupacionin, përgjegjësinë e lartë të kufitarëve për të ruajtur sa më mirë kufirin. Nga 34 propozime që janë bërë, 29 prej tyre, pasi janë analizuar, diskutuar, janë vënë në jetë. Ato janë mendimi krijues i pashtershëm i kufitarëve. Do të dish kush i ka bërë? Lexo: Petriti: "Pse të rrijë e mbyllur gjatë natës çezma që ndodhet në...?" Jashari: "Në sektorin "X" pika më dominuese në krahun e majtë. Pikërisht atje të dalë njësiti e jo atje ku del tani. Prej andej sheh më larg, më shumë,

më mirë dhe nuk të shohin." Dhe kështu, faqe pas faqeje njihesh me propozimet e kufitarëve.

... Ndërsa nata mbështolli malet për rreth dhe postën e largët kufitare, njësitet e shërbimit njoftonin me radhë për gadishmërinë e tyre. Atje në vijën e kufirit, bijt e popullit vigjëlonin, shtërngonin fort armët në duar, atje ata manifestonin më mirë se kudo dashurinë e flaktë për Partinë dhe Atdheun, atje shkruanin dhe poezinë më të bukur, më burrërore. Kështu, atje në postën kufitare, jeta rrjedh e papërmbajtëshme, me të gjithë madhështinë, heroikën dhe optimizmin e saj revolucionar, jetë që i jep më tepër shkëlqim ky jubileu ynë i lavdishëm.

## TREGIM PËR KUFITARËT

### 1. Historik brezash

Komisari çfleton historikun e postës. Janë mbushur shumë faqe dhe mbeten akoma dhe shumë të tjera për t'u mbushur. Kanë shkruar në të shumë duar dhe akoma duar të tjera do të shkruajnë. Ai është një historik brezash. Dhe çdo brez kufitarësh ka lënë në të gjurmë heroizmi i lavdie, ashtu siç do të lenë të tjerët më pas. Është libri që përmban historinë e lavdishme të postës. Është një copë e historisë së madhe që ka shkruar Atdheu në këtë çerek shekulli edhe në atë sektor të kufirit, që ruajnë kufitarët e postës "N". Edhe aty në atë "copë" të tokës amtare, ku kanë qëndruar bijt e Atdheut në roje, janë dërmuar armiqtë që kanë guxuar ta prekin, edhe aty fortesa socialiste është bërë varr i tyre e flamuri ynë i kuq ka vluar e valon kënar.

Në një nga faqet e këtij libri komisari lexon: "Ne i shërbejmë Atdheut me mish e me shpirt, ne do ta mbrojmë kufirin qoftë dhe duke bërë sakrificën supreme... Ne i mbajmë gjithënjë sytë hapur. Kjo është porosia e Atdheut, e partisë. Në sajë të kësaj vigjilence, njësitë i përbërë nga kufitarët Skënderi, Shaqiri, Haxhiu, kapi agentin e zbulimit të shtetit fqinj..."

Më poshtë mëson se një kufitar zbuloi dhe, sëbashku me shokët, kapi një tjetër armik që dërgohej nga ana e

tejme e piramidës. Në një faqe tjetër përshkruhet rasti, se si në orët e vona të një nate ishte dhënë alarm në postë dhe kufitarët si vetëtima, kishin mbyllur kufirin. Atë natë, një tjetër armik kishte ngritur duart i tmerruar përpara grykës së pushkës së kufitarit tonë. Ja dhe një nga rastet më të fundit. Xhevdeti e Faslliu kishin orë të tëra që qëndronin midis shqopeve dhe vrojtonin. Diku lëvizi një degë. Pas pak dhe një tjetër. Përgjimi dhe vështrimi i kufitarëve u bënë më të mprehtë. S'kaloi shumë dhe përpara bajonetave të tyre, armiku që vinte nga shteti fqinj, mbeti si e ngrirë në vend.

Por historinë e postës nuk e përbën vetëm ky libër nga i cili çkëputëm vetëm disa radhë. Jeta e secilit kufitar është një libër më vete, një botë e madhe, e pasur.

## 2. Komisari

Ishin vitet e para të pasqirimit. Shërbeja në një postë kufitare, diku në jugë të Atdheut. Ishin të rralla netët kur vinim gjumë në sy. Monarkofashistët grekë dërgonin vazhdimisht spiunë, diversantë, kryenin provokacione. Kështu që ishin të shpeshta ato netë që ndesheshin me armiqtë.

Një mbrëmje, komandanti më thirri në zyrë e më ngarkoi një detyrë të vështirë.

— Do të marrësh me vete një kufitar të ri — më tha, por sido që të jetë përgjegjësia bie mbi ty. Ti je komunist. Sipas të dhënave, në atë sektor mund të kalojë një "dhelpër" e regjur...

Binte shi. U lagëm sapo dolëm nga posta. Në vendin e caktuar arritëm kur u err. Ngado, male të lartë, të thepisur. Poshtë nesh oshëtinte një përrua.

Pasi i caktova detyrën kufitarit të ri, zëmë pozicionet. Të ftohtit po na hynte në palcë. Por duhej të qëndronim

pa lëvizur, me veshë të ngritur, me sytë të ngulur në errësirë. Dëshëronim vetëm një gjë: të pushonte shiu, se na pengonte të dallonim zhurmat. Por shiu nuk kishte në mënd të pushonte.

Në një çast, ktheva kokën nga shoku im më i ri. S'e dalloja dot, aq mirë ishte maskuar. I bëra shenjë të afrohej. Erdhi. I thashë të më qëndronte më pranë, që për çdo rast të merreshim vesh më mirë. Dhe veprova drejt. Se ja, ndoshta ishte mezi i natës, kur midis gjëmimit të përroit dhe zhurmës që bënte shiu, veshët diçka më kapën. M'u forcua bindja kur këtë ma vërtetoj dhe kufitari i ri. Pas pak një kërcitje tjetër, tamam si e para: një degë e thatë peme ishte thyer.

— Ndonjë egërsirë — më foli me ngadalë kufitari i ri. Heshtëm dhe pritëm. Më në fund dalluam vetëm hijen e armikut. I thirrëm të dorëzohej, s'u bind e ne hapëm zjarr mbi të. Hodha dhe një granatë. Dëgjuam një uluritje si prej bishe. Por "bishën" vetë nuk po e shikonim dot.

— Mos na iku? — foli i shqetësuar kufitari i ri.

S'ka ku të vejë — i thashë — dhe u turrëm pas drejtimit të ulurimës. Aty, buzë përroit, me kokën të zhytur në ujin e turbullt gjetëm kufomën e armikut. Edhe në errësirë, plumbat tonë ia kishin gjetur zemrën...

Këto na i tregoi Livani, komisar, atë kohë që kishte çfletuar historikun e postës: Ai asnjëherë nuk e harron që ka qenë vetë kufitar.

### 3. Netë kufitare

Në kufi, jeta është sa heroike, aq dhe interesante. Atje bijtë e popullit, kaliten, brumosen përmes vështirësive, atje ata manifestojnë cilësitë e larta moralo-luftarake të vetë popullit.

“Edhe atë natë, si në shumë të tjera, u dha sinjali i

alarmit. Rreshtohemi. Komisari më merr mua dhe Ademin e nisemi. Eoim sa na hanë këmbët. S'pyesim as për shqopet që na pengojnë e na fshikullojnë në fytyrë, na çjerrin, as për tokën e lagur që na bën të rrëshqasim.

Kontrolluam gjurmët. Pastaj u kthyem. Kishte kaluar një egërsirë. Akoma s'ishim futur në fjetore, kur u përsërit sinjali i alarmit. Nuk pritëm urdhër, se e dinim ç'duhej të bënim.

— Ti Ferit ktheu, të vijë një tjetër, — tha komisari.

— Ç'bëra unë, ç'bëri një tjetër, njësoj është, shoku komisar.

U pamë sy në sy dhe pastaj u nisëm përsëri drejt shqo-peve. U kthyem kur zbardhi dita. Kështu janë tek ne netët e zakonshme kufitare”.

#### 4. Një gëzim

... U njoftuam se do të mblidhej kolektivi. Do të diskutohet se ç'duhej të bënim më tej për të rritur kujdesin në ruajtjen e kufirit shtetëror. Me qënë se kishte dhe gjysmë ore kohë, shkova tek komisari dhe kërkova historikun.

U ula dhe nisa të çfletoja faqet njëra pas tjetrës. Ndalo-  
lova atje ku bëhet fjalë për veprimet e një njësitit që kapi një thyes. Mora shënim ç'më duhej dhe dola. Desha të këshillohesha me një shok, por s'munda. Vajti ora dhe mbledhja filloi. Ndërsa komandanti e shokët flisnin, unë bluaja mendimet me vete: “Si të bëj — thosha — të ngrihem, ta bëj propozimin?” Druhesha. Unë, një kufitar i thjeshtë, do të jepja një mendim që kishte të bënte me shërbimin. Por kur kujtova porosinë e komisarit, se të gjithë ne jemi përgjegjës përpara atdheut e partisë për mbrojtjen e kufirit të shenjtë, mora kurajo dhe fola:

— Në sektorin “X”, dikur armiqtë janë përpjekur të

kalojnë. Por s'kanë mundur. Dakort. Por unë mendoj se në atë sektor duhet të organizojmë shërbim të vazhdueshëm. Për këto arsye... — U ula dhe prita çdo të thoshin shokët dhe eprorët.

— Po ushqimin? — pyeti dikush.

— Ta marrim me vete — u përgjigja aty për aty.

Kështu filloi diskutimi rreth propozimit tim. Ç'ta zgjat. Të nesërmen, në mbrëmje, Xhemali bëri këtë komunikim: "Në sektorin "X" do të shkojë njësitë me në krye Rustemin..." Sa u gëzova, që unë i pari, do të filloja shërbimin e vazhdueshëm pikërisht atje, ku vjete më parë, njësitet tona kishin zënë sa e sa armiq".

## 5. Shokët

— Unë do të hedh dritë mbi një aspekt tjetër të jetës sonë kufitare, foli Qamili e pikërisht mbi shoqërinë ushtarake. Dhe këtë po e ilustroj me një shëmbëll.

Po përgatiteshim të hanim darkën, bile u ulëm edhe në tavolina por shumica s'arriti as ta provonte gjellën pse u dha alarm. Për mbylljen e një drejtimi, u ngarkova unë, Alushi dhe Ademi. Në kohën e caktuar, njoftuam në postë për arritjen në vend. Atje qëndruam në gadishmëri, disa orë. Pastaj muarëm urdhër dhe u kthyem në postë. Shokët e tjerë, që s'kishin shërbim, po flinin. Njeri nga ne, foli:

— Si të bëjmë, ta zgjojmë Selmanin?

— A kini uri? — u thashë shokëve.

— Mos pyet — u përgjegj Alushi.

— E po, atëhere...

Por krevati i Selmanit ishte bosh. Njëherë na shkoi mendja se mos e kishin nisur me shërbim. Dhe vendosëm ta hanim ushqimin të ftohtë. Por posta e shërbimit na tha:



— Selmani po u pret.

“Nuk mund të shtrihem pa ardhur shokët. Ata duhet ta hanë gjellën të ngrohtë” — i kish thënë.

E gjetëm Selmanin duke mbajtur pranë zjarrit pjatat tona, bile edhe bukën na i kishte thekur. Të mos harrojmë: mezi i natës ndoshta kishte kaluar. Ndoshta ky rast që tregova është nga më të thjeshtët, por shoqëria jonë kufitare këtu hedh rrënjët e pastaj rritet, fuqizohet, bëhet e pathyeshme.

## 6. Kritika dhe autokritika

“...Ishim caktuar të kontrollonim një sektor të kufirit.

— Ti Bujar, më urdhëroi përgjegjësi i njësitit, shiko me imtësi e kujdes nga krahu i djathtë... Po ta përsërit: me kujdes.

U nisa, por me vete thashë: “E pse gjithë këto porosi, sikur jam i ri unë dhe nuk di”. Fillova kontrollin. Kisha krijuar bindjen se syrit tim s’mund t’i shpëtonte gjë. Dhe m’u duk se në sektor, në krahun që m’u caktua, s’kishte asnjë gjurmë, prandaj raportova:

— Në rregull!

— Kontrolluat mirë? — pyeti ai. Përgjegjësi i njësitit më shikoi mua. “Kot e ke që dyshon, atje s’ka gjurmë” — foli me vete, me besim të patundur.

Pas pak, ndodhi ajo që nuk e prisnja. Diku, vetë komandanti kishte lënë një gjurmë. Për ta zbuluar atë, duhej vigjilencë, mprehtësi, mjeshtëri. Gjithçka varej tek një plis i vogël i cili sa ishte anuar pak.

U zura ngushtë. Në mbrëmje, Feriti, sekretari i organizatës më tha se nuk e kisha kryer mirë detyrën, se kisha çfaqur shënjë të uljes të vigjilencës e të mbi vleftësimit të aftësive. Përgjegjësi i njësitit gjithashtu, më tërhoqi vërejtjen. Kur shokët, të nesërmen, u mbledhën për

të diskutuar rreth figurës morale të ushtarakut, qenë të shumtë ata që thanë se kishte filluar të më rritej mëndja. U bë shkak ky diskutim që unë të pyesnja veten: “Janë të vërteta këto?... E po — thashë — shokët të mirën më duan, jo të keqen, prandaj të thellohem në ato që më thanë ata”. Kështu, u ngrita e bëra autokritikë, dhe tek ne, ajo bëhet e hapur, pa u ndrojtur ashtu siç bëhet dhe kritika.

\*

\*

\*

Por jeta e kësaj poste shëmbëllore, e dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me urdhërin e Yllit të Kuq të klasit të tretë, është më e pasur, më e gjërë e më e gjithanëshme. Këto që treguam janë vetëm disa aspekte.

---

## PASQYRA E LËNDES

1. Në kudhrën e revolucionit . . . . .	5
2. Motivet . . . . .	12
3. Një nga krahët e hekurt të partisë . . . . .	18
4. Provë kalitjeje . . . . .	23
5. Nga portreti i një kolektivi . . . . .	28
6. Malet rrinë zgjuar, malet vigjëlojnë . . . . .	33
7. Atje shkruhet poezia më e bukur, më burrërore . . . . .	46
8. Tregim për kufitarët . . . . .	54